


KARTA E VLERËSIMIT



CILI ËSHTË REZULTATI I PËRGJITHSHËM I KOSOVËS PËR KUJDESIN NDAJ FËMIJËVE?



Raporti Karta e Vlerësimit është zhvilluar nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF, në kuadër të projektit “Fuqizimi i akterëve të shërbimeve sociale për të ofruar shërbime cilësore dhe të qëndrueshme për fëmijët dhe familjet e cenueshme në Kosovë”, i cili mbështetet nga UNICEF në Kosovë në partneritet me USAID në Kosovë.

Përmbajtja dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UNICEF në Kosovë apo të USAID në Kosovë.

Publikuar nga:

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF
Shkurt 2024

Adresa. Sejdi Kryeziu, HY.1 K.4, Nr. 14, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 220 287
info@komfkosova.org

FËMIJËT NË KOSOVË¹



30%

e popullsisë së përgjithshme në Kosovë janë fëmijë²




22.8%

e fëmijëve jetojnë në varfëri, **7%** e fëmijëve jetojnë në varfëri ekstreme³



4%

Vetëm 4% e buxhetit të Kosovës është ndarë për politika dhe shërbime sociale në 2022⁴



579

fëmijë pa kujdes prindëror⁵



viktima të trafikimit fëmijë⁶



2,341

kallëzime penale për të mitur⁷

592

raste të incidenteve të dhunës të fëmijëve në shkolla dhe përreth tyre⁸

117 raste të vdekjes së foshnjave në vitin 2022¹¹

Shkalla e mbulueshmërisë me vaksinat **91%** sipas kalendarit të vaksinimit të fëmijëve¹²



Mesatarja e furnizimit me barna nga lista esenciale për vitin **2022** ishte **45%** në kujdesin parësor shëndetësor¹³

523

raste të fëmijëve viktima të dhunës në familje⁹

16

vjeç është moshë mesatare e fillimit të përdorimit të drogave nga të rinjtë¹⁰

- Vetëm **15%** e fëmijëve të moshës **3-4** vjeç ndjekin programe të edukimit në fëmijërinë e hershme¹⁴
- Kosova ka zënë vendin e 76 në mesin e 80 shteteve pjesëmarrëse në PISA **2022**
- Vetëm **609** shkolla kanë qasje për fëmijët me aftësi të kufizuara¹⁵
- Vetëm rreth **200** psikologë dhe pedagogë për **1047** shkolla¹⁶

¹ Të dhënat e fundit për fëmijët në Kosovë

² Agjencia e Statistikave të Kosovës

³ Agjencia e Statistikave të Kosovës

⁴ Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2022

⁵ Ministria e Drejtësisë, 2022

⁶ Ministria e Drejtësisë, 2022

⁷ Raport Vjetor i Punës së Prokurorit të Shtetit, 2022

⁸ Policia e Kosovës, 2022

⁹ Ministria e Drejtësisë, 2022

¹⁰ Organizata Labyrinth, 2022

¹¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2022

¹² Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, 2022

¹³ Asociacioni i Komunave të Kosovës, 2022

¹⁴ Anketë e Treguesve të Shumëfishtë MICS 2020, Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe UNICEF

¹⁵ Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, 2022

¹⁶ Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

Parathënie	6
Falenderime	7
Metodologjia	8
Karta e Vlerësimit: Notimi	9
Çfarë mund të mësojmë nga notat në Kartën e Vlerësimit?.....	10
MIRËQENIA SOCIALE	13
MBROJTJA E FËMIJËS	21
SHËNDETI	29
ZHVILLIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME	39
ARSIMI	43
DREJTËSIA PËR TË MITUR	48



PARATHËNIE

Kosova ka ndërmarrë hapa në krijimin e politikave dhe kornizës ligjore për mbrojtjen e fëmijëve. Kosova duhet të zbatojë legjislacionin dhe të sigurojë burimet adekuate përmes së cilave do të fuqizojë sistemin e mbrojtjes së fëmijëve.

Hyrja në fuqi e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, ka krijuar një momentum të ri juridik në kuptim të mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë. Ky momentum dhe obligim ligjor kërkon nga institucionet që të ndërmarrin veprime konkrete për të bërë funksionale dhe zbatuar dispozitat e këtij ligji që në përmbajtje është i pari i këtij lloji në Kosovë.

Për të realizuar dhe zbatuar mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, duhet një vetëdijësim, mobilizim dhe ngritje e kapaciteteve rreth rolit dhe përgjegjësisë, duke filluar nga familja, institucionet për mbrojtjen e fëmijës dhe komuniteti.

Karta e Vlerësimit vë në pah se Kosova ka një boshllëk të madh mes legjislacionit të miratuar dhe zbatimit të tij. Përmes saj, synojmë të prezantojmë boshllëqet ndërmjet politikave dhe zbatimit përmes fakteve të disponueshme dhe duke ofruar një bazë të përgjithshme, që do të hapte debatet mbi politikën për mbrojtjen e fëmijëve dhe zbatimin e tyre.

Kosova duhet të bëjë investime financiare për të ndërtuar kapacitetet që do të zvogëlonin hendekun midis legjislacionit të miratuar dhe zbatimit të tij.

Karta e Vlerësimit ofron mundësi që të gjithë aktorët të unifikojnë dhe fuqizojnë të kuptuarit e situatës së mbrojtjes së fëmijëve në vendin tonë. Presim që qeveria, komunat, donatorët, shoqëria civile, të përdorin rekomandimet nga Karta e Vlerësimit në rritjen e ofrimit të shërbimeve, kapacitetit institucional, llogaridhënies, për mbylljen e hendekut midis legjislacionit dhe zbatimit të tij.

Donjeta Kelmendi

Drejtoreshë Ekzekutive

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve

FALENDERIME

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF, dëshiron të falenderojë të gjithë ata që kontribuan për hartimin e Kartës së Vlerësimit.

KOMF është mirënjohës për të gjithë bashkë-autorët e raportit, profesionistët nga institucionet publike dhe organizatat anëtare për ofrimin e të dhënave dhe mbështetjen e tyre gjatë gjithë procesit, dhe kolegët tanë për punën e tyre të palodhur në redaktimin e raportit.

KOMF falenderon ekspertin ndërkombëtar George Bogdanov për zhvillimin e metodologjisë të Kartës së Vlerësimit për kontekstin e Kosovës si dhe mentorimin përgjatë gjithë procesit të hartimit të raportit.

Vlerësojmë veçanërisht mbështetjen e zyrtarëve të Departmentit të Shërbimeve Sociale dhe Mbrojtjes së Fëmijëve, Shërbimit Sprovues dhe Shërbimit Korrektues në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe Departmentit për Skema dhe Transfere Sociale në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Divizionit për të Drejtat e Njeriut dhe Divizionit për Arsimin Gjithëpërfshirës në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Po ashtu vlerësojmë mbështetjen e zyrtarëve të Ministrisë së Shëndetësisë, Policisë së Kosovës, Asociacionit të Komunave të Kosovës, Klinikës së Pediatriës, Klinikës së Psikiatriës në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, Spitaleve rajonale, Qendrave të Shëndetit Mendor dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës për ofrimin e informacioneve dhe të dhënave të fundit zyrtare për situatën e fëmijëve.

KOMF dëshiron veçanërisht të falenderojë anëtarët e komisionit të vlerësimit të jashtëm, të cilët kontribuan me ekspertizën e tyre lidhur me përmbajtjen e raportit.

AUTORËT

Arbër Xharra, Handikos Gjakovë
Besim Kodra, Shoqata për të Drejtat e Pacientëve
Bukureza Surdulli, Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve
Burim Behluli, SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë
Donjeta Kelmendi, Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve
Fatmire Haliti, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
Gani Lluga, ASTRA
Gresa Kelmendi, Qendra për Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore
Hana Zylfu Haziri, Qendra për Arsim e Kosovës
Hatixhe Hoxha, Autizmi
Ibadete Krasniqi, Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror
Klevis Vaqari, Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve
Loreta Keqekolla, Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve
Marije Vuksani, Terre des hommes në Kosovë
Mevlude Murtezi, Childproof Ciprof
Muharrem Ademi, Qendra Labyrinth
Pajtimi Zeqiri, Terre des hommes në Kosovë
Pëtrit Tahiri, Qendra për Arsim e Kosovës
Remzije Krasniqi, SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë
Rexhep Gojnovci, Organizata Rinore AKTI
Sebahate Beqiri, Down Syndrome Kosova
Teuta Abrashi, Qendra për Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore
Vlorian Molliqaj, Aksioni për Nëna dhe Fëmijë
Yllka Avdiu, Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve

Vlerësuesit e jashtëm:

Blerita Perolli Shehu – Eksperte për çështje sociale
Ardian Klaiqi – Ekspert ligjor
Natyra Agani Destani – Eksperte për çështje psikologjike

METODOLOGJIA

Cili është rezultati i përgjithshëm i Kosovës për kujdesin ndaj fëmijëve? Ky është edicioni i parë i raportit vjetor të monitorimit të Koalicionit të OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF mbi gjendjen e fëmijëve dhe zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.

Metodologjia e monitorimit për kontekstin e Kosovës përmes “Kartës së Vlerësimit” është zhvilluar nga eksperti ndërkombëtar për mbrojtje të fëmijëve, George Bogdanov. George është njëherit udhëheqës i Koalicionit për Mbrojtje të Fëmijëve në Bullgari, të cilët për më shumë se 10 vite tashmë e monitorojnë situatën e të drejtave të fëmijëve përmes “Kartës së Vlerësimit” dhe kanë qenë faktor motivues për KOMF për të filluar këtë proces.

Ky instrument përdoret edhe nga shumë organizata të tjera të shoqërisë civile në vende të ndryshme të botës, sikurse në Irlandë, Suedi, Gjermani, Kanadë, Kaliforni, etj.

Qëllimi kryesor i KOMF përmes këtij raporti është realizimi i monitorimit të pavarur të shoqërisë civile në fushën e të drejtave të fëmijëve në baza vjetore, të bazuar në fakte dhe dëshmi. Raporti ofron të dhëna për gjendjen e të drejtave të fëmijëve, nivelin e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës dhe jep rekomandime, të cilat priten të mbështesin përmirësimin e politikave dhe shërbimeve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë.

Fushat në të cilat është analizuar progresi për politikën, legjislativën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe zbatimin e tyre janë: Mirëqenia sociale; Mbrojtja e fëmijës; Shëndeti i fëmijës; Zhvillimi në fëmijërinë e hershme; Arsimi dhe Drejtësia për të mitur.

Raporti përfshin fakte dhe të dhëna mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Kosovë për fushat e cekura më lart. Analiza bazohet në të dhëna dhe burime zyrtare, dhe nuk është vlerësim subjektiv i KOMF. Burimet e të dhënave janë të cituara në referencat përkatëse.

Krahas kritikës konstruktive, raporti fokusohet edhe në arritjet, si dhe ku ka pasur mangësi apo regres.

Duke synuar një vlerësim sa më transparent dhe të paanshëm, është kërkuar mbështetje nga ministritë, agjencitë dhe institucionet publike në mbledhjen e të dhënave dhe informacioneve mbi progresin e arritur dhe sfidat në fushat përkatëse. Më pas ky informacion i detajuar është përdorur si bazë e analizës në secilën fushë. Burimet e tjera përfshijnë të dhënat nga raportet e organizatave joqeveritare, agjencive dhe institucioneve shtetërore dhe publikimeve mediatike.

Autorët në këtë raport kanë ofruar një vlerësim të fushave. Vlerësimi bazohet në sistemin e notimit sikurse notimi i nxënësve në shkollat e Kosovës, nga nota një deri në notën pesë, sikurse: nota “1= Pamjaftueshëm”, nota “2 = Mjaftueshëm”, nota “3 = Mirë”, nota “4 = Shumë mirë” dhe nota “5 = Shkëlqyeshëm”. Autorët kanë ofruar argumentet konkrete që mbështesin notën. Duke qenë se një fushë mund të ketë më shumë se një autor, (domethënë bashkëautorë të fushave), është përdorur metoda e mesatares aritmetike, pra vlerësimet e autorëve janë përdorur për të arritur në vlerësimin përfundimtar dhe mesataren e përgjithshme të fushës.

Procesi përfshin edhe vlerësuesit e jashtëm të cilët kanë ofruar po ashtu vlerësimin e tyre përmes notimit. Raporti i rënë dakord në kuadër të KOMF (pa notat e vendosura nga autorët), i është dërguar vlerësuesve të jashtëm së bashku me kriteret e vlerësimit. Grupi i vlerësimit të jashtëm përbëhet nga ekspertë dhe profesionistë me përvojë për fushat e trajtuara në raport. Në fund të këtij vlerësimi, është organizuar një takim i përbashkët me vlerësuesit e jashtëm, për të diskutuar dhe validuar vlerësimin përfundimtar.

KARTA E VLERËSIMIT: NOTIMI

Shkalla e notimit për fushat e trajtuara në raport është nga **1 deri në 5**, me udhëzimet përkatëse për vlerësimin dhe notimin. Vlerësimi është realizuar sipas udhëzimeve të detajuara për vlerësim, nga shqyrtimi i situatës në vend, të

drejtat e fëmijëve, politikat për fëmijët dhe familjet, vendimet dhe veprimet e marra nga institucionet për zgjidhjen e problemeve, zbatimi i këtyre vendimeve, ndikimi i tyre tek fëmijët dhe familjet.

Si bazë për vlerësimin, janë përdorur udhëzimet e mëposhtme:

Vlerësimi/ Nota	Progresi
5	Institucionet shtetërore kanë zbatuar me sukses veprimet, duke realizuar me sukses masat e ndërmarra, të cilat kanë treguar efikasitet. Ky sukses ka sjellë një ndryshim të rëndësishëm, pozitiv, të qëndrueshëm dhe të dukshëm në jetën e fëmijëve dhe familjeve në Kosovë. Ky vlerësim jepet për përpjekjet e vazhdueshme të institucioneve për të zbatuar me sukses veprimet, duke siguruar një ndikim pozitiv të vazhdueshëm për fëmijët dhe familjet.
4	Ka përkushtim, planifikim dhe janë ndërmarrë hapa konkretë. Ky angazhim ka ndikim për një grup të gjerë të fëmijëve. Institucionet tregojnë përkushtim duke ndjekur plane të strukturuar dhe duke kryer veprime për të adresuar sfidat. Rezultatet janë të dokumentuara për një grup të caktuar të fëmijëve. Ky vlerësim është i vlefshëm edhe në rastin kur institucionet kanë shprehur vullnet politik për zgjidhjen e problemeve dhe kanë hartuar plane për zbatimin e veprimeve, megjithatë ende nuk janë arritur rezultate për të gjithë grupin e fëmijëve të përfshirë në këto planifikime.
3	Institucionet deklarojnë se do të angazhohen në adresimin e problemeve dhe janë të gatshme për të zhvilluar plane, megjithatë, hapat e ndërmarrë vonohen, shtyhen, dhe nuk sjellin rezultatet përfundimtare të nevojshme. Në përkushtimin e tyre për zgjidhjen e çështjeve, institucionet kanë shfaqur një vullnet politik dhe kanë hartuar plane të strukturuar, megjithatë, ende nuk janë arritur rezultate për të gjithë grupet e fëmijëve për të cilët janë hartuar planet.
2	Institucionet deklarojnë se janë të përkushtuar në zgjidhjen e problemeve, megjithatë, nuk sigurojnë burimet e nevojshme financiare dhe njerëzore, dhe ka mungesë të veprimeve reale dhe të qëndrueshme. Edhe pse institucionet kanë shprehur vullnetin për të adresuar çështjet, hapat e ndërmarrë janë minimalë, sporadikë, dhe/ose jo konsistentë, pa sjellë rezultate të dukshme. (Kjo mund t'i atribuohet mungesës së kompetencës së institucioneve shtetërore kryesore për zgjidhjen e problemeve).
1	Institucionet nuk ndërmarrin veprime konkrete për të adresuar problemet dhe nuk njohin rekomandimet për zgjidhjen e çështjeve (ato nuk janë në fokus të prioriteteve të institucionit përgjegjës). Veprimet e ndërmarra janë të gabuara dhe nuk ka rezultate. Në përgjithësi, ndonëse institucionet kanë një pozicion mbështetës, veprimet nuk kanë sjellë efektin e dëshiruar.

FUSHA	NOTIMI
1. MIRËQENIA SOCIALE	2.6
2. MBROJTJA E FËMIJËS	2.5
3. SHËNDETI I FËMIJËS	2.25
4. ZHVILLIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME	2.25
5. ARSIMI	2.5
6. DREJTËSIA PËR TË MITUR	2

ÇFARË MUND TË MËSOJMË NGA NOTIMI NË KARTËN E VLERËSIMIT?

MIRËQENIA SOCIALE

Nota: 2.6

Kosova orienton mbështetjen e mirëqenies sociale së fëmijëve dhe familjeve kryesisht përmes transfereve sociale. Sistemi aktual i mbrojtjes sociale në Kosovë, nuk arrin mjaftueshëm të adresojë nevojat e ndryshme të fëmijëve dhe familjeve të cenueshme. Transferet sociale kanë ndikim shumë të kufizuar në uljen e varfërisë së fëmijëve dhe familjeve, duke rezultuar me shkallë të lartë të varfërisë së fëmijëve krahasuar me shtetet e tjera në rajon. Hap pozitiv vlerësohet të jetë inicimi i procesit të rishikimit të legjislacionit për asistencë sociale i cili pritet të eliminojë kriteret diskriminuese për fëmijët dhe përfshirjen më të madhe të fëmijëve dhe familjeve që jetojnë në varfëri. Arritje vlerësohet të jetë miratimi i Ligjit të ri për Shërbime Sociale dhe Familjare, i cili hap zyrtarisht procesin e reformës së shërbimeve sociale në vend. Sfidë kryesore në fushën e shërbimeve sociale mbetet financimi i paqëndrueshëm duke rrezikuar mbylljen apo uljen e cilësisë së shumë shërbimeve sociale për fëmijët dhe familjet në nevojë. Projektligji për Financat e Pushtetit Lokal i finalizuar që disa vite, i cili pritet të krijojë Grantin e Veçantë për Shërbime Sociale dhe rregullimin e financimit të qëndrueshëm për shërbime sociale, nuk është miratuar. Procesi i kostimit të shërbimeve sociale dhe hartimit të formulës së financimit edhe pse i nisur vite më parë, nuk arriti të finalizohet. Po ashtu, nuk ka pasur një hartëzim të shërbimeve dhe nevojave të popullatës për shërbime që do të informonte edhe politikëbërjen qendrore dhe komunale në hartimin e programeve dhe planifikimin e programeve sociale dhe shërbimeve konform nevojave.

MBROJTJA E FËMIJËVE

Nota: 2.5

Megjithëse Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës ka hyrë në fuqi nga viti 2020, ky ligj nuk ka gjetur akoma zbatim të plotë. Legjislacioni sekondar që buron nga ky ligj nuk është kompletuar akoma. Nga 17 udhëzimet administrative që burojnë nga ky ligj, nëntë prej tyre janë miratuar, përderisa tetë udhëzime administrative të tjera nuk janë miratuar. Shërbimet dhe programet e reja të parapara në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës ende nuk janë themeluar. Parandalimi nuk ka gjasa të jetë ende element thelbësor i shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës. Po ashtu, linja telefonike falas për fëmijë dhe shtëpitë për mbrojtjen e fëmijës nuk janë themeluar akoma. Ndër sfidat kryesore në mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror mbetet vonesa në zgjidhjen e statusit të fëmijëve pa kujdes prindëror, shërbimet për fëmijët pa kujdes prindëror në kushte të vështira dhe ata pas moshës 18 vjeçare. Hap pozitiv është rritja e pagesës mujore për fëmijët në strehim familjar dhe zhvillimi i programeve të dedikuara për ngritjen e kapaciteteve për familjet strehuese për fëmijët pa kujdes prindëror, prindërit potencial adoptues dhe profesionistët. Në Kosovë, aktualisht kemi një sistem të fragmentuar të mbrojtjes së fëmijëve, për pasojë shërbimet në mes të sektorit të arsimit, mirëqenies dhe shëndetësisë nuk janë të integruara. Problematikë vazhdon të mbetet identifikimi dhe raportimi apo vetë raportimi i fëmijëve në situata të dhunës si dhe trajtimi i rasteve të dhunës nga sistemi. Kosova vazhdon të mos ketë shërbime të specializuara për të adresuar mbrojtjen dhe reintegrimin e fëmijëve të përfshirë në punë të rënda. Sa i përket trafikimit, ndër sfidat më të mëdha mbetet identifikimi i fëmijëve viktimë të trafikimit, trajtimi nga sistemi i drejtësisë dhe reintegrimi afatgjatë. Me qëllim të adresimit të trafikimit në mënyrë të planifikuar dhe koordinuar me të gjitha autoritetet, Qeveria miratoi Strategjinë Kombëtare Kundër Trafikimit me Njerëz.

SHËNDETI I FËMIJËVE

Nota: 2.25

Të dhënat statistikore lidhur me shkallën e gjdhënies, numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, numrin e fëmijëve që konsumojnë duhan, alkool dhe numrin e fëmijëve përdorues të drogave mungojnë. Vdekshmëria e foshnjave në Kosovë, megjithëse është zvogëluar ndër vite, vazhdon të mbetet ende më e larta në krahasim me shtetet e rajonit. Shkalla e mbulueshmërisë me vaksinat për fëmijë arrin në 91%.¹⁷ Arritje ishte zgjerimi i Kalendarit të vaksinimit me tre vakcina të reja për fëmijët, vakcina kundër rotavirusit, vakcina kundër pneumokokut e meningjitit dhe vakcina HPV, kundër kancerit të qafës së mitrës. Sa i përket sistemit shëndetësor terciar, funksionalizimi i spitalit të ri kirurgjikpediatrik ka përmirësuar përkujdesin shëndetësor të fëmijëve. Mungesa e barnave në kujdesin parësor shëndetësor, spitalet rajonale dhe në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës vazhdon të mbetet problematike. Ligji për Sigurime Shëndetësore i miratuar në vitin 2014, asnjëherë nuk ka hyrë në fuqi. Mbështetja shtetërore për ofrimin e shërbimeve shëndetësore rehabilituese për fëmijët me aftësi të kufizuara mbetet shumë e kufizuar. Vendi ynë vazhdon të mos sigurojë shërbime dhe programe të qëndrueshme parandaluese të cilat janë më se të nevojshme duke parë trendet në rritje të përdorimit të drogave nga fëmijët dhe adoleshentët.¹⁸ Kosova nuk ofron shërbime të veçanta të rehabilitimit për fëmijët viktime të abuzimit me narkotikë. Numri i kërkesave nga fëmijët për shërbime të shëndetit mendor është rritur sidomos pas pandemisë Covid-19. Më qëllim të ruajtjes së mirëqenies së plotë fizike dhe mendore, Ministria e Shëndetësisë miratoi Planin e veprimit për shëndet mendor pas pandemisë COVID-19. Megjithatë, burimet në dispozicion për shëndetin mendor të fëmijëve në institucionet publike shëndetësore janë shumë të kufizuara. Konsumimi i pijeve energjike është një tjetër shqetësim për shëndetin e fëmijëve në Kosovë dhe vazhdon të mos ketë një rregullim ligjor për këtë çështje.

ZHVILLIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME

Nota: 2.25

Kosova vazhdon të mbetet vendi me përfshirjen më të ulët të fëmijëve në edukimin parashkollor krahasuar me vendet në rajon. Shkaku kryesor për një pjesëmarrje kaq të ulët është kapaciteti i vogël absorbues i rrjetit të institucioneve parashkollore dhe vetëdija e përgjithshme për format tradicionale të edukimit brenda familjes. Institucionet parashkollore kryesisht janë të fokusuar në zona urbane, përderisa zonat rurale janë pothuajse të përjashtuara nga qasja në shërbime për zhvillim në fëmijëri të hershme. Ka mungesë të programeve të mjaftueshme alternative për mbështetjen e prindërve, shërbimeve për ndërhyrje të hershme në ambient familjar, mungesë të qendrave ditore, qendrave mësimore, qendrave në komunitet, grupeve mbështetëse të prindërve. Fëmijët që vijnë nga grupet e cënueshme edhe pse janë të liruar nga pagesa, shumë shpesh nuk përfshihen në institucionet parashkollore. Kujdesi dhe edukimi në fëmijërinë e hershme janë edhe më kritike tek fëmijët me aftësi të kufizuara, ku identifikimi dhe ndërhyrja e hershme mungojnë në masë të madhe. Shërbimet për zhvillimin në fëmijërinë e hershme nuk janë të integruara mes sektorëve të arsimit, shëndetësisë dhe atë të mirëqenies sociale. Hap pozitiv ishte miratimi i Ligjit për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, i cili ndër të tjera pritet të fillojë integrimin e shërbimeve në fëmijërinë e hershme. Përderisa, Kurrikula për Edukim në Fëmijërinë e Hershme edhe pse proces i nisur vite më parë, nuk arriti të miratohet.

¹⁷Të dhënat nga Ministria e Shëndetësisë, 2022

¹⁸Të dhënat nga Organizata Labyrinth

ARSIMI

Nota: 2.5

Arsimi ballafaqohet me sfida dhe probleme të shumta, të cilat reflektojnë në cilësinë jo të mirë të arsimit në Kosovë. Kosova është renditur ndër të fundit në Programin Ndërkombëtar për Vlerësimin e Nxënësve, PISA, ku ka zënë vendin e 76 nga 80 shtete pjesëmarrëse për lexim, ndërsa është në vendin e 77 nga 80 për shkencë. Ka shumë faktorë të cilët ndikojnë që Kosova të ketë cilësi të ulët në arsim, sikurse, cilësia e performancës së mësimdhënësve, cilësia e teksteve mësimore, numri tejet i madh i nxënësve në klasa e sidomos në qytete, mungesa e infrastrukturës në shkolla, menaxhimi jo i mirë, politizimi i kuadrove arsimore në shkolla, mos funksionimi i bashkëpunimit në mes të prindërve, mësimdhënësve dhe nxënësve, llogaridhënia e ulët, etj. Institucionet e Kosovës kanë bërë hapa në avancimin e politikave dhe legjislationit duke tentuar zbatimin e konceptit të gjithëpërfshirjes si pjesë integrale në të gjitha politikat në arsim. Megjithatë sa i përket zbatimit të politikave dhe zhvillimit të mekanizmave që sigurojnë gjithëpërfshirjen, ende ka shumë punë për të bërë. Shumica e komunave kanë themeluar ekipet komunale për vlerësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara por në shumicën e komunave ekipet nuk janë funksionale. Shkollat kanë mungesë të stafit profesional dhe mbështetës sikurse psikologë, pedagogë dhe asistentë për fëmijë me aftësi të kufizuara. Më konkretisht, as çereku i shkollave nuk kanë psikologë/e të punësuar në shkollë. Veprim për tu vlerësuar, ishte vendimi i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për punësimin e 100 asistentëve për fëmijë me aftësi të kufizuara. Sipas të dhënave zyrtare braktisja e shkollimit është e një shkalle të ulët, por si fenomen konsiderohet më i pranishëm dhe shqetësues tek komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Po ashtu, ekipet për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos regjistrimit në arsimin e obliguar në nivel shkolle nuk funksionojnë si duhet në shumicën e komunave. Qendrat mësimore në komunitet janë duke u përballur me një sërë sfidash për shkak të mungesës së financimit dhe neglizhencës së përgjegjësive institucionale, duke rrezikuar edhe mbylljen e tyre.

DREJTËSIA PËR TË MITUR

Nota: 2

Shërbimet për parandalimin dhe mbrojtjen e të miturve në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale mungojnë në masë të madhe. Kjo ndodh për shkak të kapaciteteve tejet të kufizuara në kuadër të Qendrave për Punë Sociale si dhe mungesës së theksuar të shërbimeve edhe nga sektori joqeveritar. Hap pozitiv ishte themelimi i Ekipit për monitorimin dhe zbatimin e Udhëzimit Administrativ për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve kryerës të veprave penale nën moshën e përgjegjësisë penale. Edhe pse Kodi i ri i Drejtësisë për të Mitur (KDM) ka dyfishuar masat e diversitetit, të cilat luajnë një rol vendimtar në parandalimin e fillimit të procedurave gjyqësore kundrejt të miturve dhe nxitjen e rehabilitimit dhe reintegrimit të tyre në shoqëri, zbatimi i masave të diversitetit ballafaqohet me sfida. Për më tepër, vitet e fundit vihet re një rënie e theksuar e zbatimit të këtyre masave në sistemin e drejtësisë për të mitur. Të miturit me masë edukuese korrektuese mbahen në institucion të tipit të mbyllur, gjë që përbën shkelje të dispozitave të Kodit të Drejtësisë për të Mitur (KDM), rrjedhimisht shkelje të rëndë të të drejtave themelore të fëmijëve. Kjo për shkak se në Qendrën Edukative të tipit të hapur nuk bëhen pranime të drejtpërdrejta sipas vendimit të Gjykatës, por vetëm transfere nga Qendra Korrektuese. Një shqetësim i vazhdueshëm, është fakti që në mungesë të një qendre korrektuese për të miturat femra, ato vendosen në qendër me të paraburgosurat/dënuarat e rritura. Konstatohet numër i madh i zyrtarëve korrektues dhe numër tejet i vogël i stafit profesional. Organizimi aktual ka synim primar sigurinë, pengimin e ikjes së të miturve duke neglizhuar në masë të madhe punën në rehabilitim, edukim dhe reintegrim të të miturve, që përbën edhe qëllimin e dhënies së masave.



MIRËQENIA SOCIALE

MIRËQENIA SOCIALE

Nota: 2.6

- ▶ Transferet sociale kanë ndikim shumë të kufizuar në uljen e varfërisë së fëmijëve dhe familjeve
- ▶ Financim i paqëndrueshëm që rrezikon mbylljen apo uljen e cilësisë së shumë shërbimeve sociale për fëmijët dhe familjet
- ▶ Mungesë e hartëzimit të shërbimeve dhe nevojave të popullatës për shërbime



TË DHËNAT DEMOGRAFIKE DHE TË DHËNAT E PËRGJITHSHME



30%

E POPULLSISË SË PËRGJITHSHME NË KOSOVË JANË FËMIJË

Kosova ka popullsinë e përgjithshme prej 1,739,825 banorëve. Papunësia përfshin shkallën prej 11.8%.¹⁹

Paga mesatare është 521 Euro. Vlen të përmendet që gjatë vitit 2022, inflacioni ishte në shkallë të lartë prej 11.58%.²⁰

Aktualisht në Kosovë, përkrahja sociale është e orientuar drejt ndihmës monetare mujore në kuadër të skemave sociale. Ndërsa, vazhdon të ketë mungesë të programeve alternative për mbështetje dhe fuqizim të familjeve, përmes ofrimit të shërbimeve të nevojshme.²¹

Buxheti për financimin e skemave sociale dhe pensionale për vitin 2022, për pjesën e mirëqenies sociale, mbrojtjes sociale dhe fushën e punësimit ka qenë mbi 600 milion Euro për financimin e skemave të rregullta, pa përfshirë mbështetjet e ofruara të pagesave të dyfishta apo shtesave që janë realizuar për kategoritë sociale dhe pensionale në dy muajt e fundit të vitit 2022, që janë financuar sipas vendimeve të

qeverisë dhe masave nga programi i ringjalljes ekonomike. Sa i përket përqindjes së shpenzimeve të politikave sociale dhe shërbimeve sociale (pagesa në kesh për familje në asistencë sociale, strehim familjar, pagesa për familje që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara, pagesa për shtesat e fëmijëve dhe lehonat, mbështetja me programin e subvencionimit të energjisë për familjet e varfëra, mbështetja për sektorin OJQ-ve përmes thirrjeve publike dhe financimi i institucioneve rezidenciale në nivel qendror) ka qenë rreth 4% e Buxhetit të Kosovës të aprovuar për vitin 2022.²²

VARFËRIA E FËMIJËVE DHE PROGRAMET PËR FUQIZIM TË FAMILJES

Kosova vazhdon të ketë shkallë të lartë të fëmijëve që jetojnë në varfëri dhe nivele të larta të përjashtimit social të fëmijëve. Për katër vitet e fundit nuk ka të dhëna zyrtare për varfërinë e fëmijëve. Ndërsa sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës të vitit 2019, në Kosovë, 22.7% e fëmijëve jetojnë në varfëri, ndërsa 7% jetojnë në varfëri ekstreme.



22.7%

E FËMIJËVE JETOJNË NË VARFËRI

¹⁹ Të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2022

²⁰ Të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2022

²¹ Raporti i Monitorimit të Shërbimeve Sociale, KOMF 2022, https://komfkosova.org/wp-content/uploads/2022/05/Raporti-i-monitorimit_AL-1-1.pdf

²² Të dhënat zyrtare nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2022

Këto të dhëna shqetësuese shpërfaqin sfidat e një pjese të madhe të fëmijëve në Kosovë, të cilët përjetojnë kequshqyerjen, mungesën e veshmbathjeve të nevojshme dhe kushtet e dobëta të jetesës, të cilat pengojnë mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijëve.

Varfëria e fëmijëve dhe përjashtimi social janë pasojë e shumë faktorëve, të tillë si papunësia, niveli i ulët arsimor i popullsisë, shëndeti i dobët, mungesa e qasjes në shërbime, kujdesi i ulët në fëmijërinë e hershme, dhe faktorë të tjerë të ngjashëm. Pabarazitë më të mëdha vazhdojnë të ndodhin tek fëmijët më të varfër, fëmijët nga komunitetet e marginalizuara, si komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe fëmijët me aftësi të kufizuara.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka vazhduar të implementojë skemat me qëllim zvogëlimin e varfërisë dhe fuqizimin e familjeve në Kosovë. Programi kryesor për mbështetjen e familjeve ka qenë Skema e Asistencës Sociale dhe Shtesat për Fëmijë²³.

Program tjetër për mbështetjen e familjeve ishte edhe programi për mbështetjen e lehonave të papuna dhe të punësuar, ku kanë përfituar rreth 7,000 lehona të papuna në vlerë prej 170 Euro për 6 muaj dhe rreth 1,500 lehona të punësuar në vlerë prej 170 Euro për 3 muaj.²⁴

Po ashtu, Qeveria përmes disa programeve, me mbështetjen edhe nga donatorët është angazhuar në zbatimin e disa masave si për shembull punësimi i së paku një anëtari të familjes për familjet që nuk kanë të punësuar, angazhimi në punë i personave me aftësi të kufizuara dhe përfshirja e të rinjve në punë.²⁵ Ndërkaq, nuk ka të dhëna nëse nga këto masa ka përfituar ndonjë person që është në skemën e asistencës sociale. Këto masa janë zbatuar përmes programit të ringjalljes ekonomike gjë që është problematike sepse është program i përkohshëm dhe nuk siguron qëndrueshmëri.

Investimet nuk kanë qenë të mjaftueshme për të bërë një ndryshim në popullatën e përgjithshme, në zvogëlimin e varfërisë dhe në zvogëlimin e pabarazive mes fëmijëve. Zgjerimi i programeve për zvogëlimin e varfërisë dhe fuqizimin e familjes, sigurimi i qasjes së barabartë në shërbime, dhe sigurimi i financimit të qëndrueshëm janë hapa të domosdoshëm për përmirësimin e mirëqenies së fëmijëve dhe familjeve të cenueshme në Kosovë.

SKEMA E ASISTENCËS SOCIALE



45,000

FËMIJË PËRFITUES TË SKEMËS SË ASISTENCËS SOCIALE²⁶



275,444

FËMIJË KANË PËRFITUAR NGA SHTESAT PËR FËMIJË NË VLERË 10 APO 20 EURO²⁷

Gjatë vitit 2022, 22,980 familje ishin përfitues të ndihmës sociale, ndërsa numri i anëtarëve të familjes ishte 90,806. Prej tyre, rreth 45,000 fëmijë apo 50% e tyre ishin fëmijë që përfituan edhe një shtesë prej 10 euro si pjesë e ekonomisë familjare. Shuma e asistencës sociale ishte nga 70 deri në 250 Euro në muaj. Po ashtu, familjet në asistencë sociale si rezultat i inflacionit kanë përfituar pagesë të dyfishtë në dy muajt e fundit të vitit 2022.²⁸ Shuma mujore e ndihmës sociale është shumë e vogël për të përballuar kushtet elementare të jetesës për një familje, sidomos me inflacionin e ndodhur në tre vitet e fundit.

Skema e asistencës sociale financohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, përdërisa administrohet nga Qendrat për Punë Sociale në secilën komunë.

Skema e asistencës sociale nuk është mirë e adaptuar dhe nuk përfshin të gjithë fëmijët dhe familjet që jetojnë në varfëri. Edhe zyrtarët nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve kanë deklaruar se një numër i familjeve dhe fëmijëve që kanë gjendje të rëndë ekonomike, nuk janë pjesë e përftimeve nga skema e asistencës sociale. Kjo për shkak të kriterëve të Ligjit për Asistencë Sociale, sikurse kriteri ku përcaktohet se familja duhet të ketë të paktën një fëmijë nën moshën 5 vjeç për të përfituar nga skema e asistencës sociale, konfirmimi dhe vlerësimi që anëtarët e ekon-

²³Të dhënat nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2022

²⁴Të dhënat nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2022

²⁵Të dhënat nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2022

²⁶Të dhënat nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2022

²⁷Të dhënat nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2022

²⁸Të dhënat nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2022

omisë familjare ti nënshtrohen vlerësimeve të komisioneve mjekësore për aftësinë e mbetur për punë, mungesa e identifikimit të të hyrave dhe të ardhurave të sakta për të matur nivelin e mirëqenies së ekonomisë familjare, etj.²⁹ Kriteri (i) në Kategorinë e II, Neni 4, ku përcaktohet që familja duhet të ketë të paktën një fëmijë nën moshën 5 vjeç, është diskriminues dhe absolutisht i papranueshëm nga të gjithë akterët e përfshirë në skemë por edhe nga vetë përfituesit. Sipas këtij kriteri familjet në varfëri që nuk kanë fëmijë nën moshën 5 vjeçare bien në pozitë të pafavorshme, ky kriter përjashton edhe familjet që kanë marrë asistencë sociale deri sa fëmija ka mbushur moshën 5 vjeç, pikërisht kur fëmija duhet të fillojë të shkollohet dhe rrjedhimisht dhe familja do të ketë shpenzime edhe më të mëdha. Të gjitha këto mangësi pritet të adresohen dhe rregullohen me Ligjin e ri të Skemës së Asistencës Sociale, ku pritet të eliminohen kriteret diskriminuese dhe të krijohen mundësitë që ekonomitë familjare me të ardhura të ulëta nën nivelin e përcaktuar të mund të përfitojnë nga mbështetja e skemës së asistencës sociale. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka nisur procesin e hatimit të Projektligjit të ri të Skemës së Asistencës Sociale, megjithatë, ky projektligj nuk është miratuar. Si rrjedhojë, ligji në fuqi vazhdon të përmbajë kritere diskriminuese për fëmijët, duke shkelur kështu të drejtat themelore të tyre.

Në përgjithësi, sistemi aktual i mbrojtjes sociale në Kosovë, ndonëse ofron një ndihmë financiare, nuk arrin të adresojë nevojat e ndryshme të familjeve dhe fëmijëve të cenueshëm. Është e domosdoshme të ketë një qasje më gjithëpërfshirëse për të siguruar qasje të barabartë në shërbimet e mbështetjes dhe fuqizimin e plotë të familjes. Aktualisht, skema e asistencës sociale e administruar nga Qendrat për Punë Sociale funksionon e ndarë, pothuajse tërësisht e izoluar nga shërbimet sociale. Vlerësohet që një pjesë e konsiderueshme e familjeve që jetojnë në varfëri, kanë nevojë për shërbime sociale dhe familjare. Prandaj, është më se e domosdoshme integrimi i skemës së asistencës sociale dhe shërbimeve sociale të ofruara në kuadër të Qendrave për Punë Sociale si dhe ndërlidhja e tyre me zyrat për punësim.

SHTESAT PËR FËMIJË

Nga viti 2021, Qeveria ka filluar ofrimin e shtesave për fëmijët, ku ka vendosur modelin e skemave sociale universale, duke ofruar shtesa në vlerë të barabartë për të gjithë fëmijët

pa marrë parasysh statusin ekonomik të familjes. Gjatë vitit 2022 kanë përfituar gjithsej 275,444 fëmijë. Të gjithë fëmijët e moshës 0 - 24 muaj kanë përfituar shtesë në vlerë prej 20.00 Euro në muaj, ndërsa fëmijët mbi moshën 2 deri 16 vjeç kanë përfituar shtesë në vlerë prej 10.00 Euro në muaj.³⁰

Shtesat për fëmijë ofrohen për fëmijët deri në moshën 16 vjeçare, pra nuk përfshihet mosha 17 deri 18 vjeç. Sipas legjislacionit në Kosovë përkufizimi fëmijë përfshinë moshën 0 deri 18 vjeç, prandaj shtesat për fëmijë duhet të mbulojnë fëmijët deri në 18 vjeç. Aktualisht, shtesat për fëmijë nuk kanë një bazë ligjore të qëndrueshme, ofrohen bazuar në një vendim në kuadër të pakos emergjente nga periudha Covid - 19. Është më se i domosdoshëm hartimi i bazës ligjore për shtesat për fëmijë për të siguruar qëndrueshmërinë e tyre. Shuma mujore e ndarë është e ulët, nuk është e mjaftueshme për të përballuar nevojat e fëmijëve.

Po ashtu, fëmijët e cenueshëm sikurse fëmijët pa kujdes prindëror dhe një pjesë e fëmijëve që vijnë nga familjet e marginalizuara nuk kanë përfituar nga shtesat për fëmijë, kjo për shkak të pamundësisë për të aplikuar në platformën e-kosova.³¹

PËRKRAHJA MATERIALE E FAMILJEVE TË FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Në Kosovë është e përcaktuar e drejta për ndihmë materiale për fëmijët me aftësi të kufizuara si element i mbrojtjes për këtë kategori. Megjithatë, Ligji për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme nuk garanton mbrojtje gjithëpërfshirëse për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara, por njeh të drejtën për kompensim material vetëm për fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme fizike, mendore dhe shqisore, të cilët janë plotësisht të paaftë të kryejnë aktivitetet e përditshme jetësore pa kujdesin e personit tjetër.³² Ky ligj ofron mbështetje për vetëm rreth 3,000 fëmijë me aftësi të kufizuara, duke përjashtuar pjesën dërrmuese të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Prandaj, si i tillë ai bën diskriminim dhe nuk mbulon të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara. Për më tepër, mbështetja financiare prej 100 euro që i ofrohet fëmijëve dhe familjeve të tyre është e pamjaftueshme për nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara


²⁹ Të dhënat nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2022

³⁰ Të dhënat nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2022

³¹ Të dhënat nga SOS Fshatrat e Fëmijëve dhe Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror

³² Ligji për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme, <https://tinyurl.com/3xsudpaz>

SHËRBIMET SOCIALE



38

QENDRA PËR PUNË SOCIALE NË 38 KOMUNA
ME 404 ZYRTARË³³



50

ORGANIZATA TË LICENSUARA PËR OFRIMIN
E SHËRBIMEVE SOCIALE³⁴

Shërbimet sociale ofrohen nga Qendrat për Punë Sociale, ofruesit e tjerë publik si dhe rreth 50 organizata joqeveritare të licensuara për ofrimin e shërbimeve sociale.

Në territorin e Kosovës janë 38 Qendra për Punë Sociale në 38 komuna me rreth 404 zyrtarë, ku prej tyre 164 janë zyrtarë të shërbimeve sociale. Qendrat për Punë Sociale janë organet kryesore të autoriteteve publike komunale të mandatuara për të ofruar shërbime sociale për fëmijët dhe familjet në nevojë, si dhe për të koordinuar një sistem të integruar të shërbimeve. Qendrat për Punë Sociale nuk kanë pasur burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare për ofrimin e shërbimeve sociale. Qendrat për Punë Sociale ishin të mbingarkuara me reagim në raste emergjente, duke lënë mënjanë shërbimet parandaluese dhe shërbimet reintegruese. Kjo ishte si pasojë jo vetëm e numrit të pamjaftueshëm të zyrtarëve në Qendra për Punë Sociale, por edhe për shkak të mos përcaktimit të formulës për numrin e zyrtarëve të shërbimeve sociale në raport me numrin e popullsisë apo numrin e rasteve.



85

LËNDË MESATARISHT PËR NJË ZYRTAR
TË SHËRBIMEVE SOCIALE



VETËM 10 MILIONË
EURO PËR SHËRBIME
SOCIALE³⁵



VETËM 8 INSPEKTIVE
TEK OFRUESIT E SHËRBIMEVE SOCIALE
GJATË VITIT 2022³⁶

Ngarkesë më e lartë e rasteve në raport me zyrtarin e shërbimeve sociale regjistrohet sidomos në komunat më të mëdha si për shembull Qendra për Punë Sociale Ferizaj, e cila ka paraqitur që një zyrtar ka 270 lëndë në vit dhe Qendra për Punë Sociale Prishtinë, e cila ka paraqitur që një zyrtar ka 318 raste në vit. Vetëm 28% e Qendrave për Punë Sociale kanë kushtet infrastrukturore relativisht të mira, përderisa pjesa tjetër e Qendrave për Punë Sociale ofrojnë shërbimet në hapësira të papërshtatshme fizike.



GJYSMA E QPS-ve
NUK KANË QASJE PËR FËMIJËT ME
AFTËSI TË KUFIZUARA

Mbi gjysma e Qendrave për Punë Sociale kanë qasje të vështirësuar ose të pamundshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në Qendra për Punë Sociale ekziston një prezencë e pabalancuar e profesioneve, kryesisht dominon profili i juristit, pasuar nga profilet si sociolog, pedagog, psikolog

³³ Analiza e Qendrave për Punë Sociale, KOMF dhe Ministria e Drejtësisë, 2023

³⁴ Analiza e Qendrave për Punë Sociale, KOMF dhe Ministria e Drejtësisë, 2023

³⁵ Të dhënat nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2022

³⁶ Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë, 2022

dhe punëtor social. Vlen të theksohet se vetëm 12 punëtorë socialë janë të punësuar në Qendra për Punë Sociale.³⁷

Shërbimet kryesore të ofruara nga Qendrat për Punë Sociale ishin vlerësimi, këshillimi, realizimi i kontaktimit mes familjarëve, dhënia e mendimit profesional, vendosja e fëmijëve pa kujdes prindëror në format themelore të mbrojtjes juridike dhe familjare, për personat me aftësi të kufizuara dhe persona të moshuar, referimi i rasteve për marrjen e shërbimeve të specializuara adekuata sipas kategorive në sektorin joqeveritar.³⁸

50 organizata joqeveritare të licensuara kanë ofruar shërbime të specializuara për kategori të veçanta të fëmijëve. Konkretisht, 10 strehimore kanë ofruar shërbime rezidenciale 24 orë për mbrojtjen, rehabilitimin dhe reintegrimin e fëmijëve viktime të dhunës në familje, abuzimit, neglizhimit dhe trafikimit. Rreth 30 qendra ditore për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara kanë ofruar shërbime sociale në baza ditore për intervenimin e hershëm të fëmijët me aftësi të kufizuara, shërbime psiko sociale, rehabilituese dhe këshilluese dhe shërbime për fuqizimin e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Shërbimet e tjera të ofruara nga organizatat joqeveritare përfshijnë shërbimet në mbështetje të kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror, sikurse shërbimet për fëmijët pa kujdes prindëror në familje strehuese dhe SOS familje, shërbimet për fuqizimin e familjes dhe parandalimin e braktisjes së fëmijëve, mbështetjen e të rinjve. Po ashtu shërbime janë ofruar për fëmijët përdorues të substancave narkotike. Një qendër ditore për fëmijët në situatë rruge është hapur në Nashec, në Komunën e Prizrenit, duke u bërë qendra e dytë ditore për këtë kategori të fëmijëve në nivel vendi.³⁹

Arritje e rëndësishme ishte miratimi i Ligjit të ri për Shërbime Sociale dhe Familjare i nisur prej pesë vitesh, i cili zhvillon reformën e shërbimeve sociale. Nga ky projektligj pritet që fëmijët, familjet dhe qytetarët në nevojë të marrin shërbime sociale dhe familjare më cilësore dhe të qëndrueshme. Ligji i ri pritet të sjell risitë sikurse: Rritjen e gamës së shërbimeve, themelimin e shërbimeve të reja duke përcaktuar shërbimet e parandalimit, mbrojtjes, rehabilitimit dhe reintegrimit; Krijimin e një skeme të hapur të ofrimit të shërbimeve sociale në mes të sektorit publik, joqeveritar dhe atij privat; Zhvillimin dhe fuqizimin e shërbimeve në familje dhe shërbimeve me bazë në komunitet; Ndarjen e përgjegjësisë të institucioneve të nivelit qendror dhe komunal; Fuqizimin e inspektimit përmes dhënies së kompetencave ekzekutive; Rregullimin e kontraktimit të shërbimeve sociale dhe familjare.

Sfidë kryesore e ofruesve të shërbimeve sociale nga sektori joqeveritar mbetet financimi i paqëndrueshëm për ofrimin e shërbimeve sociale nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe komunat.⁴⁰ Vlen të përmendet që krahasuar

me vitet paraprake, financimi për strehimoret ka qenë më i qëndrueshëm.



FINANCIMI PËR SHËRBIME SOCIALE MBETET VETËM PËR PERIUDHA TË SHKURTRA

6 DERI NË 10 MUAJ

Megjithatë, financimi ka vazhduar të ofrohet përmes subvencioneve për periudha të shkurtra disa mujore (6 deri në 10 muaj) dhe i pabazuar në nevojat e përfituesve. Përderisa, shërbimet sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara të ofruara nga qendrat ditore kanë mbetur kryesisht nën mbështetjen e agjencive dhe donatorëve të huaj, ndërkohë që mbështetja shtetërore mbetet shumë e kufizuar. Natyra e paqëndrueshme e këtyre shërbimeve minimizon përfshirjen e plotë të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe kufizon një plan afatgjatë rehabilitimi të nevojshëm që ndihmon fëmijët me aftësi të kufizuara të përmbushin potencialin e tyre.⁴¹

Komunat dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve nuk kanë krijuar një skemë të qëndrueshme të kontraktimit për blerjen e shërbimeve sociale nga sektori joqeveritar, mbështetja ndaj organizatave joqeveritare është ofruar në baza ad hoc dhe përmes subvencionimit. Shuma e ndarë për projektet e organizatave joqeveritare konsiderohet e pamjaftueshme dhe mbulon një pjesë të vogël të kostos së përgjithshme të shërbimeve. Duhet theksuar që kohëzgjatja e shkurtër e thirrjeve të publikuara dhe zbrazëtitë kohore mes thirrjeve të Ministrisë dhe komunave, po shkaktojnë në vazhdimësi vështirësi në funksionimin e ofruesve të shërbimeve sociale. Buxheti i ndarë nga komunat kryesisht është ndarë proporcionalisht në shumën të barabarta në mes të ofruesve të shërbimeve pa marrë parasysh nevojat e përfituesve. Kjo mënyrë e financimit po rrezikon me mbylljen e shërbimeve të ofruara nga sektori joqeveritar, prandaj rekomandohet ndërhyrje e menjëhershme për zhvillimin e një skeme të qëndrueshme përmes krijimit të një mekanizmi të veçantë dhe më të thjeshtë të blerjes së shërbimeve, që merr në konsideratë specifikat e shërbimeve sociale dhe ofruesit potencial të tyre. Për shkak të ndjeshmërisë së shërbimeve sociale, ato duhet të paraqiten si kategori e veçantë në Ligjin për Prokurimin Publik.⁴²

³⁷ Analiza e Qendrave për Punë Sociale, 2023, <https://komfkosova.org/analiza-mbi-gjendjen-aktuale-te-qendrave-per-pune-sociale/>

³⁸ Analiza e Qendrave për Punë Sociale, 2023, <https://komfkosova.org/analiza-mbi-gjendjen-aktuale-te-qendrave-per-pune-sociale/>

³⁹ Të dhënat nga organizata anëtare Terre des hommes

⁴⁰ Raporti i monitorimit për shërbime sociale, KOMF 2022, https://komfkosova.org/wp-content/uploads/2022/05/Raporti-i-monitorimit_AL-1-1.pdf

⁴¹ Të dhënat nga Down Syndrome Kosova, Qendra e Kujdesit Ditor Pema, Handikos Gjakovë, Handikos Ferizaj

⁴² Analiza e Qendrave për Punë Sociale, Ministria e Drejtësisë dhe KOMF, 2023, <https://komfkosova.org/analiza-mbi-gjendjen-aktuale-te-qendrave-per-pune-sociale/>

Po ashtu skema e qëndrueshme e kontraktimit dhe financimi i bazuar në nevoja nuk mund të bëhet pa pasur kostim të shërbimeve sociale dhe formulë financimi. Procesi i kostimit dhe hartimit të formulës së financimit edhe pse i nisur pesë vite më parë, nuk arriti të finalizohet. Po ashtu, nuk ka pasur një hartëzim të shërbimeve dhe nevojave të popullatës për shërbime që do të informonte edhe politikëbërjen komunale dhe qendrore në hartimin e programeve dhe planifikimin e shërbimeve konform nevojave.

Financimi total për shërbime sociale gjatë vitit 2022 ishte rreth 10 milionë Euro. Shërbimet sociale janë kompetencë vetanake komunale dhe bazuar në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal financohen nga komunat përmes dy burimeve të financimit që janë, granti i përgjithshëm dhe të hyrat vetanake komunale. Problemi për shërbime sociale fillon pikërisht këtu, sepse nga këto shuma buxhetojnë të gjitha departamentet dhe kjo formë nuk garanton që do të ketë ndarje të mjaftueshme në mënyrë që të sigurohet minimumi i financimit për shërbimet sociale. Kjo sepse nuk ka një formulë financimi të ndarjes së shumës për shërbimet sociale operative dhe kapitale. Në mënyrë që ky funksion komunal të mos mbetet në vullnet të nivelit komunal, është sugjeruar krijimi i Grantit të Veçantë për Shërbime Sociale.⁴³ Projektligji për Financat e Pushtetit Lokal i finalizuar që disa vite, i cili pritet të krijojë Grantin e Veçantë për Shërbime Sociale dhe rregullimin e financimit të qëndrueshëm për shërbime sociale, nuk është miratuar.⁴⁴ Me hyrjen në fuqi të Projektligjit për Financat e Pushtetit Lokal dhe krijimit të grantit të veçantë për shërbime sociale llogaritet që buxheti për shërbime sociale do të rritet për 10 milionë në vitin e parë të zbatimit të këtij ligji.⁴⁵

Llogaridhënia në fushën e shërbimeve sociale vazhdon të mos jetë e rregulluar. Mandati i monitorimit dhe inspektimit i shërbimeve sociale ka vazhduar të jetë i paqartë dhe i padefinuar. Njësia për Monitorim dhe Inspektim në kuadër të Ministrisë ende nuk ka kompetenca ekzekutive, ka funksion këshilldhënës, gjë që e zbeh rolin e inspektimit tek ofruesit e shërbimeve sociale.⁴⁶ Po ashtu, sfidë përbën numri i vogël i stafit për inspektimin e shërbimeve sociale, ku aktualisht janë të angazhuar vetëm dy zyrtarë për inspektim. Gjatë 2022, prej rreth 120 ofruesve të shërbimeve sociale publik dhe joqeveritar gjithsej janë realizuar vetëm 8 inspektime.⁴⁷

Proceset e strukturuar të menaxhimit të të dhënave nuk janë në tërësi funksionale. Në radhë të parë raportohet se baza e të dhënave e shërbimeve sociale nuk furnizohet mjaftueshëm dhe në mënyrë të rregullt me të dhëna, por edhe ato të dhëna që futen në bazën e të dhënave nuk përdoren as për planifikim të shërbimeve apo buxhetit, e as si bazë për zhvillim të programeve apo politikave. Mangësi tjetër është që qasje në këtë bazë të të dhënave kanë vetëm Qendrat për Punë Sociale, nuk përfshihen edhe të dhënat për përfituesit nga ofruesit jo qeveritarë dhe privatë të shërbimeve sociale.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për herë të parë në vitin 2022, ka filluar hartimin e programeve të trajnimeve të nevojshme për shërbime sociale, të cilat i nënshtrohen procesit të akreditimit. Në total parashihen të hartohen dhe akreditoen 24 programe për shërbime sociale. Aktualisht nuk ka programe të akredituara të trajnimeve për shërbime sociale dhe trajnimet ofrohen në baza ad hoc dhe varen kryesisht nga mbështetja e donatorëve apo organizatave joqeveritare. Prandaj kjo nismë vlerësohet si hap pozitiv për ngritjen e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve sociale.

⁴³ Doracaku për Planifikimin, Financimin dhe Kontraktimin e Shërbimeve Sociale, KOMF, https://komfkosova.org/wp-content/uploads/2023/11/Doracaku_ALB.pdf

⁴⁴ Të dhënat nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2022

⁴⁵ Të dhënat nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, 2022

⁴⁶ Qëndrimi për Ligjin e ri për Shërbime Sociale dhe Familjare, KOMF, Institucioni i Avokatit të Popullit, Asociacioni i Komunave, Asociacioni i Qendrave për Punë Sociale, SOS Fshatrat e Fëmijëve, Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror, https://komfkosova.org/wp-content/uploads/2021/04/Qendrimi-LSHSF_alb_compressed.pdf

⁴⁷ Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë, 2022

Rekomandime:

- ▶ Miratimi i Ligjit të ri për Asistencë Sociale, largimi i kriterëve diskriminues për fëmijët. Rritja e shumës mujore të asistencës sociale për të përballuar inflacionin e ndodhur në vitet e fundit;
- ▶ Hartimi dhe miratimi i bazës ligjore për shtesat për fëmijë; Përfshirja e moshës 17 deri 18 vjeç në kuadër të shtesave për fëmijë; Rritja e shumës së shtesave për fëmijë;
- ▶ Mundësimi i përfitimit të shtesave për fëmijët pa kujdes prindëror dhe fëmijët nga familjet e marginalizuara;
- ▶ Integrimi apo ndërlidhja e shërbimit të asistencës sociale me shërbimet sociale dhe familjare dhe zyrat për punësim me qëllim uljen e varfërisë, rritjen e mirëqenies së familjes dhe rritjen e punësimit;
- ▶ Zhvillimi dhe zbatimi i shërbimeve dhe programeve për mbështetjen e familjeve, duke synuar ofrimin e shërbimeve me familjen në qendër dhe ofrimin e shërbimeve të integruara;
- ▶ Zhvillimi dhe zbatimi i një strategjie për fuqizimin e familjes për të ndihmuar familjet të adresojnë sfidat ekonomike dhe sociale dhe të përmirësojnë mirëqenien e tyre të përgjithshme. Shërbimet sociale, fuqizimi ekonomik dhe programet për prindërim të mirë duhet të jenë të disponueshme për të gjitha familjet që jetojnë në varfëri dhe identifikohen në nevojë;
- ▶ Miratimi i legjislationit të ri për njohjen e statusit, vlerësimit dhe mbështetjen e të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- ▶ Hartëzimi i shërbimeve ekzistuese sociale dhe nevojave aktuale në secilën komunë, për të identifikuar saktësisht shërbimet që mungojnë dhe për të planifikuar zhvillimin e tyre. Kjo do të ndihmonte edhe në planifikim real vjetor të shërbimeve konform nevojave dhe planifikim buxhetor të bazuar në dëshmi;
- ▶ Përcaktimi i formulës së punësimit të zyrtarëve të shërbimeve sociale nga Ministria konform nevojave të popullatës dhe krijimi i standardeve minimale për përcaktimin e ngarkesës së stafit dhe numrit mesatar të rasteve;
- ▶ Rritja e numrit të zyrtarëve me profil të "punëtorit social" dhe "psikologut" në të gjitha Qendrat për Punë Sociale;
- ▶ Përcaktimi i shërbimeve sociale të cilat mund të ofrohen nga Qendra për Punë Sociale. Shërbimet të cilat nuk mund të ofrohen nga Qendra për Punë Sociale duhet të paraqiten në planin vjetor për blerje të atyre shërbimeve nga sektori joqeveritar ose privat;
- ▶ Sigurimi i hapësirave të mjaftueshme dhe të përshtatshme të punës në Qendra për Punë Sociale, të cilat nuk i posedojnë këto hapësira. Sigurimi i qasjes për fëmijët me aftësi të kufizuara në objektet e Qendrave për Punë Sociale sipas standardeve të përcaktuara në U.A., 33/2007 si dhe atyre ndërkombëtare;
- ▶ Rishikimi dhe modifikimi i bazës së të dhënave të Qendrave për Punë Sociale dhe gjetja e modaliteteve për menaxhimin e të dhënave me qëllim të informimit në kohë reale, duke përfshirë edhe të dhënat për përfituesit nga ofruesit joqeveritarë dhe privatë të shërbimeve sociale, monitorimit dhe vlerësimit;
- ▶ Krijimi i një skeme të qëndrueshme nga Ministria dhe komunat për kontraktimin e shërbimeve sociale dhe familjare nga sektori jo qeveritar. Ministria dhe komunat duhet të rrisin pragun e financimit për shërbime sociale, duhet të eliminojnë zbrazësitë kohore në mes të thirrjeve, duhet të financojnë shërbimet për periudha tre vjeçare si dhe të lidhin kontrata me organizatat e licensuara;
- ▶ Hartimi dhe miratimi i Udhëzimeve Administrative që burojnë nga Ligji i ri për Shërbime Sociale dhe Familjare;
- ▶ Miratimi i Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal për krijimin e grantit të veçantë për shërbimet sociale dhe familjare. Ky grant do të duhet të përmbajë kriteret të qarta në mënyrë që të sigurojë ndarje të drejtë dhe financim adekuat për shërbimet sociale;
- ▶ Kostimi adekuat, sensitiv gjinor, i shërbimeve sociale dhe familjare. Formula e financimit për shërbime sociale duhet të nxjerrë koston për njësi për secilin përfitues për shërbime sociale si dhe duhet të marrë parasysh kriteret dhe indikatorët socialë në komuna;
- ▶ Plotësim ndryshimi i Ligjit për Prokurimin Publik për krijimin e një mekanizmi të veçantë dhe më të thjeshtë të blerjes së shërbimeve sociale;
- ▶ Akreditimi i programeve për shërbime sociale dhe ngritja e kapaciteteve të vazhdueshme të ofruesve të shërbimeve sociale.



MBROJTJA E FËMIJËVE

MBROJTJA E FËMIJËVE

Nota: 2.5

- ▶ Mungesë e shërbimeve parandaluese dhe shërbimeve për reintegrim afatgjatë për fëmijët
- ▶ Sistem i fragmentuar i mbrojtjes së fëmijëve, shërbimet në mes të sektorit të arsimit, mirëqenies dhe shëndetësisë nuk janë të integruara
- ▶ Identifikim, raportim dhe vetë raportim i ulët i fëmijëve në situata të dhunës



500

fëmijë pa kujdes prindëror tek farefisi⁴⁸

579

fëmijë pa kujdes prindëror⁴⁹

79

fëmijë pa kujdes prindëror në familje strehuese⁵⁰

9

adoptime vendore të realizuara⁵¹

FËMIJËT PA KUJDES PRINDËROR

Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës përcakton mbrojtjen e fëmijës pa kujdes prindëror përmes formave themelore të mbrojtjes juridike dhe familjare: kujdestaria, strehimi familjar, strehimi rezidencial, adoptimi, dhe jetesa e pavarur e mbikëqyrur.⁵²

Gjatë vitit 2022 në kujdestari janë vendosur gjithsej 579 fëmijë pa kujdes prindëror. Ndërkaq 12 fëmijë foshnje janë braktisur. Vlen të përmendet që krahasuar me vitet e kaluara, konstatohet rënie e numrit të fëmijëve të braktisur.⁵³ Në strehim familjar brenda farefisit ishin të vendosur 500 fëmijë pa kujdes prindëror. Përderisa, numri i fëmijëve në strehim familjar jashtë farefisit apo në familje strehuese ishte 79 fëmijë pa kujdes prindëror.

Në vitin 2022, janë shqyrtuar 11 kërkesa për adoptim, prej tyre 9 kërkesa për adoptim vendor janë aprovuar dhe 2 kërkesa për adoptim ndërshtetëror (kërkesa brenda familjes), janë refuzuar. Në të njëjtin vit, Qendrat për Punë Sociale kanë realizuar 5 raste të bashkimit familjar të fëmijëve të braktisur

me familjet e tyre biologjike, prej tyre: 1 rast nga fëmijët e lindur gjatë vitit 2022, ndërsa 4 raste të bartura nga vitet paraprake.⁵⁴

Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës parasheh komponentën e parandalimit, ku përcakton që duhet të parandalohen aspektet që rrezikojnë mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijës. Institucionet publike, private dhe organizatat joqeveritare, sipas mandatit të tyre, duhet të zhvillojnë masa për të parandaluar nevojën e fëmijës për ndihmë dhe për të zvogëluar problemet ekzistuese.⁵⁵

Por në praktikë, shërbimet për parandalimin e braktisjes apo ndarjes së fëmijës nga prindërit mungojnë në masë të madhe për shkak të burimeve të pamjaftueshme. Për pasojë, parandalimi nuk ka shumë gjasa të jetë element thelbësor i punës së Qendrave për Punë Sociale. Shërbimet për parandalimin e braktisjes dhe fuqizimin e familjes kryesisht ofrohen nga sektori joqeveritar. Shërbimet kryesore të

⁴⁸Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë, 2022

⁴⁹Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë, 2022

⁵⁰Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë, 2022

⁵¹Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë, 2022

⁵²Neni 22, paragrafi 1, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës

⁵³Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë, 2022

⁵⁴Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë, 2022

⁵⁵Neni 24, paragrafi 2, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës

disponueshme që ofrohen nga Qendrat për Punë Sociale për fëmijët pa kujdes prindëror janë caktimi i menaxherit të rastit dhe kujdestarit ligjor, hartimi i planit individual, strehimi i fëmijës në strehim familjar apo në strehim rezidencial, vizitat monitoruese dhe realizimi i procedurave të ribashkimit apo adoptimit. Vizitat monitoruese nuk mund të realizohen me rregull nga Qendrat për Punë Sociale për shkak të ngarkesës shumë të madhe me raste dhe pamundësisë për të arritur tek të gjithë fëmijët. Ndërsa, pjesa dërrmuese e shërbimeve sikurse rehabilitimi, mbrojtja, reintegrimi, fuqizimi, aftësimi profesional dhe pavarësimi ofrohen nga ofruesit e shërbimeve sociale të organizatave të shoqërisë civile varësisht në cilën formë të kujdesit vendoset fëmija, në familje strehuese, SOS familje/ kujdes alternativ, në strehimore, apo në shtëpi me bazë në komunitet.

Strehimi familjar për fëmijët pa kujdes prindëror konsiderohet ndër fushat ku ka pasur më së shumti progres në vitet e fundit, në aspektin e zhvillimit të legjislacionit, rritjen e investimeve dhe ngritjen e kapaciteteve. Ligji i ri për Shërbime Sociale dhe Familjare për herë të parë i njeh familjet strehuese si ofrues të shërbimeve sociale dhe hap rrugën për përfshirjen e tyre në skemën pensionale. Një hap tjetër pozitiv ishte vendimi i ndërmarrë nga Ministria e Drejtësisë për rritjen e pagesave për strehim familjar. Konkretisht, pagesa për fëmijët pa kujdes prindëror të vendosur tek të afërmit, nga 100 Euro është rritur në 150 Euro. Pagesa për fëmijët pa kujdes prindëror të vendosur në familje strehuese, nga 250 Euro është rritur në 350 Euro. Pagesa për fëmijët pa kujdes prindëror me aftësi të kufizuar të vendosur në familje strehuese, nga 350 Euro është rritur në 450 Euro.

Në vitin 2022, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve mbështetur nga SOS Fshatrat e Fëmijëve, ka zhvilluar programin ndërkombëtar PRIDE, i dedikuar për ngritjen e kapaciteteve për familjet strehuese, për trajnim të familjeve potenciale strehuese dhe prindërve potencial adoptues. Kjo qasje pritet të fuqizojë cilësinë e shërbimeve të kujdesit të strehimit familjar dhe adoptimit duke siguruar një korizë të standardizuar, të qëndrueshme dhe të strukturuar në ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve që punojnë në këtë fushë dhe për rekrutimin, përgatitjen dhe zgjedhjen e prindërve strehues dhe prindërve adoptues.⁵⁶

Ndër sfidat kryesore në mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror mbetet numri i vogël i familjeve strehuese. Aktualisht janë 38 familje strehuese që kujdesen për fëmijët pa kujdes prindëror. Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës përcakton

që çdo komunë duhet të ketë së paku tri familje strehuese për fëmijët pa përkujdesje prindërore, të vlerësuara, trajnuara dhe të aprovuara sipas standardeve të përcaktuara nga Ministria përkatëse për Mirëqenie Sociale.⁵⁷

Megjithatë familjet strehuese nuk janë të shtrira në gjithë territorin e Kosovës, aktualisht ekzistojnë vetëm në 17 komuna. Derisa komunat të cilat nuk kanë familje strehuese, duke mos përfshirë komunat me shumicë serbe janë: Peja, Mitrovica, Podujeva, Vushtria, Kamenica, Deçani, Klina, Skenderaj, Kaçaniku, Hani i Elezit dhe Juniku.⁵⁸ Familjet strehuese nuk janë të specializuara për të punuar sipas kategorive të fëmijëve.

Sfidë mbetet vonesa në zgjidhjen e statusit të fëmijëve pa kujdes prindëror dhe për pasojë mos dhënia e mundësisë për adoptim për këta fëmijë. Kryesisht kjo prek fëmijët e moshës nga 3 deri në 18 vjeç të cilët e humbin kujdesin prindëror, vendosen në strehim familjar apo rezidencial për një kohë shumë të gjatë dhe nuk konsiderohen për adoptim. Kosova është ndër vendet e vetme në Europën Juglindore me numrin më të vogël të rasteve të adoptimit të fëmijëve mbi moshën 3 vjeç për numër të popullsisë. Po ashtu, rol në mungesën e adoptimit të kësaj grupmoshe luan dhe hezitimi i vetë familjeve potenciale adoptuese për shkak të kërkesave të tyre për të adoptuar fëmijë nën moshën 3 vjeçare. Sfidë tjetër është edhe mungesa e interesimit për adoptimin e fëmijëve pa kujdes prindëror me aftësi të kufizuara.⁵⁹

Edhe pse Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës ka paraparë si formë të re jetesën e Pavarur të Mbikëqyrur që nënkupton ofrimin e shërbimeve dhe mbështetjes për fëmijët pa kujdes prindëror pas moshës 18 vjeçare deri në moshën 26 vjeç, kjo formë e mbrojtjes nuk ka gjetur akoma zbatim.⁶⁰ Shërbimet për fëmijët pa kujdes prindëror pas moshës 18 vjeçare mungojnë në masë të madhe. Si pasojë, në pamundësi që fëmija të qëndrojë në familjen strehuese pas moshës 18 vjeçare, Organi i Kujdestarisë është i detyruar të ndërpresë kujdesin dhe shërbimet, apo në rastet kur fëmija është me aftësi të kufizuara, ta vendosë fëmijën në Institutin në Shtime (strehim rezidencial), gjë që ndikon negativisht në mirëqenien e përgjithshme të fëmijës. Praktika në Kosovë tregon që fëmija pas arritjes së moshës 18 vjeçare nuk është domosdoshmërisht i përgatitur për të përballuar jetesën në mënyrë të pavarur. Kështu, shumica e shteteve e kanë zgjidhur moshën e kujdesit, ku fëmijët pa kujdes prindëror edhe pas moshës 18 vjeçare vazhdojnë të marrin mbështetje dhe shërbime deri në moshën 25-26 vjeçare, deri sa të përfundojë arsimi i plotë, aftësimi profesional dhe pavarësimi i tyre.

⁵⁶Të dhënat nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë

⁵⁷Neni 14, Roli i Komunës, paragrafi 6, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës

⁵⁸Të dhënat nga Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror, 2022

⁵⁹Të dhënat nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror, 2022

⁶⁰Të dhënat nga Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror

FËMIJËT E PËRFSHIRË NË PUNË TË RËNDA

Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës përcakton që fëmija nën moshën 18 vjeç nuk mund të punojë në punë të rrezikshme.⁶¹ Gjatë vitit 2022 gjithsej 160 fëmijë janë identifikuar në punë të rënda kryesisht në sektorët sikurse: sektori i bujqësisë dhe pylltarisë, sektori i ndërtimitarisë dhe puna në rrugë.⁶² Nga ky numër konstatohet se vetëm një pjesë e vogël e fëmijëve të përfshirë në punë të rënda janë të identifikuar nga institucionet. Për pasojë, pjesa më e madhe e fëmijëve të përfshirë në punë të rënda nuk janë pjesë e sistemit të mbrojtjes dhe nuk marrin shërbime.

Qendrat për Punë Sociale në bashkëpunim me organizatën Terre des Hommes kanë vënë në funksion ekipet mobile për identifikim të hershëm të fëmijëve në situatë rruge dhe forma të rënda të punës. Këto ekipe janë aktive në komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Gjakovë, Obiliq, Ferizaj dhe Prizren. Megjithatë, ekzistojnë kufizime të konsiderueshme të kapaciteteve për identifikimin dhe rritjen e raportimit të rasteve të përfshirjes së fëmijëve në punë.⁶³

Kosova vazhdon të mos ketë shërbime të specializuara të ofruara nga komunat për të adresuar mbrojtjen e fëmijëve të përfshirë në punë; duke përfshirë qendrat e kujdesit ditor, ekipet mobile si dhe shërbimet e rehabilitimit dhe reintegrimit (mbështetjen sociale, arsimore dhe psikologjike për fëmijët dhe familjet e tyre).



VETËM DY QENDRA TË SPECIALIZUARA PËR FËMIJËT E PËRFSHIRË NË PUNË TË RËNDA NË NIVEL TË KOSOVËS

Përrjashtim bëjnë iniciativat e disa organizatave joqeveritare, sikurse Terre des Hommes e cila drejton dy qendra ditore në Prishtinë dhe Prizren për trajtimin dhe reintegrimin e fëmijëve të përfshirë në punë të rënda me fokus trajtimin e fëmijëve në situatë rruge.

Bazuar nga të dhënat e Analizës së Qendrave për Punë Sociale, lidhur me shërbimet që mungojnë më së shumti, Qendrat për Punë Sociale dhe organizatat joqeveritare kanë identifikuar si mungesë shërbimet e parandalimit dhe shërbimet e specializuara rehabilituese dhe reintegruese për fëmijët e përfshirë në punë të rënda dhe në situatë rruge.

Sfidë tjetër është mungesa e organizatave joqeveritare që punojnë me fëmijët e përfshirë në punë të rënda në shumë komuna dhe pamundësia e kontraktimit të shërbimeve në mënyrë të qëndrueshme nga Ministria dhe komunat.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, është hartuar një version i përditësuar i Listës së Punëve të Rrezikshme të Fëmijëve si dhe Procedurat Standarde të Operimit për Fëmijët në Punë të Rrezikshme të Fëmijëve. Përveç kësaj, është krijuar një bazë e të dhënave për menaxhimin digjital të rasteve të punës së fëmijëve, me udhëheqjen e Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve dhe mbështetjen e Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

TRAFIKIMI I FËMIJËVE

Gjatë vitit 2022 janë identifikuar gjithsej 22 viktima të trafikimit, ku prej tyre 14 viktima ishin fëmijë.⁶⁴ Shfrytëzimi seksual dhe puna e detyruar vazhdojnë të jenë format dominante të trafikimit me qenie njerëzore në Kosovë. Komunitetet e marginalizuara Rom, Ashkali dhe Egjiptian janë më të rrezikuara nga lypja e detyruar dhe trafikimi seksual.⁶⁵

Ndër sfidat më të mëdha mbetet identifikimi i fëmijëve viktima të trafikimit. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit krijoi ekipe lokale shumëdisiplinore për të përmirësuar bashkërendimin për rastet e trafikimit në tre rajone. Është i domosdoshëm fuqizimi i mekanizmave për identifikim dhe raportim që do të lehtësojnë vetë-raportimin, raportimin e bashkëmoshatarëve dhe qasjen në raportim të profesionistëve të cilët vazhdimisht punojnë me fëmijët dhe të rinjtë (p.sh. mësimdhënësit, psikologët e shkollave, këshilluesit). Në Kosovë nuk planifikohen dhe nuk zbatohen programe për reintegrimin afatgjatë të fëmijëve që janë viktima të trafikimit.⁶⁶ Qasja me punën me viktimat kërkohet të jetë më e përqendruar tek viktima, më miqësore ndaj fëmijës, e ndjeshme ndaj gjinisë së fëmijës, si dhe e përshtatshme në aspektin kulturor dhe social.

⁶¹ Neni 51, paragrafi 2, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës

⁶² Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë dhe Policia e Kosovës, 2022

⁶³ Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë, 2022

⁶⁴ Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit, 2023, <https://www.state.gov/reports/2023-trafficking-in-persons-report/kosovo/>

⁶⁵ Të dhënat nga organizata Terre des Hommes

⁶⁶ Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë

Gjatë vitit 2022, Policia e Kosovës vazhdoi ta klasifikojë lypjen e detyruar të fëmijëve nga prindërit e tyre si neglizhim ose abuzim nga prindërit dhe jo si trafikim, duke deklaruar se fëmijët e shoqëruar nga prindërit e tyre nuk plotësonin përkufizimin e trafikimit. Prokurorët kishin tendencë të klasifikojnë veprat e trafikimit si vepra penale më të lehta dhe gjyqtarët vazhduan të shqiptojnë dënime të buta për trafikantët nën minimumin e dënimit të paraparë në Kodin Penal të Kosovës me pesë vite burgim.⁶⁷

Me qëllim të adresimit të trafikimit në mënyrë të planifikuar dhe koordinuar me të gjitha autoritetet, Qeveria miratoi Strategjinë Kombëtare Kundër Trafikimit me Njerëz 2022-2026.⁶⁸

Shërbimet e rehabilitimit dhe reintegrimit për fëmijët viktime të trafikimit me rrezikshmëri të lartë ofrohen nga strehimorja shtetërore e drejtuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, përderisa shërbimet e rehabilitimit dhe reintegrimit për fëmijët viktime të trafikimit me rrezikshmëri të mesme dhe të ulët ofrohen nga organizatat e shoqërisë civile me financim të pjesshëm nga shteti dhe donatorët e huaj. Mbështetja financiare e Qeverisë për strehimoret për fëmijët viktime të trafikimit vazhdon të mbetet për periudha të shkurtëra, maksimumi deri në 10 muaj. Vlen të përmendet që Ministria e Drejtësisë shtoi fondet për strehimoret e drejtuara nga organizatat joqeveritare duke mundësuar shërbime më të qëndrueshme dhe më cilësore. Po ashtu, Qeveria në Programin e Qeverisë për vitin 2021 – 2025 ka paraparë që linjën për Shërbime Bazike për Strehimoret, ta vendosë si linjë të përhershme në Ligjin për Buxhetin e Kosovës me qëllim rregullimin e qëndrueshmërisë financiare të strehimoreve.⁶⁹

⁶⁷ Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit, 2022, <https://www.state.gov/reports/2023-trafficking-in-persons-report/kosovo/>

⁶⁸ <https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/AL/2472/Strategjia%20QNJ%202022-2026.pdf>

⁶⁹ Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë, 2022

MBROJTJA E FËMIJËVE NGA TË GJITHA FORMAT E DHUNËS

Dhuna dhe ndëshkimi i fëmijëve në Kosovë mbetet një normë sociale e pranuar dhe e aplikuar nga prindërit si një mjet edukimi dhe disiplinimi për fëmijët.⁷⁰ Konstatohet nevojë e madhe për krijimin e programeve dhe shërbimeve për prindërim të mirë dhe parandalimin e dhunës në familje dhe institucione. Edhe pse Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës ka paraparë që Qeveria, sipas propozimit të Ministrisë për Arsim, nxjerr Udhëzim Administrativ, siguron programe, të cilat promovojnë edukimin, rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me pasojat degraduese të ndëshkimit trupor dhe programe prindërore që promovojnë mënyrat jo të dhunshme të disiplinimit në familje dhe shkollë⁷¹, ky udhëzim administrativ nuk është miratuar.

Vendi ynë vazhdon të mos ketë programe apo shërbime për mbështetjen e prindërve në mirërritjen e fëmijëve apo prindërimin pozitiv e si rrjedhojë institucionet publike nuk kanë pasur të dhëna për numrin e prindërve që kanë përfutur nga programet për prindërim pozitiv.⁷² Përrjashtim bëjnë disa iniciativa të organizatave të shoqërisë civile të cilat kanë ofruar trajnime për prindërimin pozitiv si dhe kanë ofruar këshillim dhe shërbime në familje me qëllim fuqizimin e familjes. Megjithatë këto iniciativa edhe pse të rëndësishme mbesin të kufizuara krahasuar me nevojat.⁷³ Aktualisht nuk ka institucione të dedikuara apo shërbime të veçanta për fuqizimin e prindërve në mirërritjen e fëmijëve. Situata mund të përmirësohet me zbatimin e Ligjit të ri për Shërbime Sociale dhe Familjare, ku parashihet themelimi i shërbimeve parandaluese përfshirë shërbimet për prindërim të mirë si dhe hapja e këshillimoreve në komuna, të cilat ndër të tjera do të kenë për qëllim fuqizimin e prindërve për mirërritjen e fëmijëve dhe parandalimin e formave të ndëshkimit ndaj fëmijës.

Problematikë vazhdon të mbetet identifikimi dhe raportimi apo vetë raportimi i fëmijëve në situata të dhunës si hap i parë për mbrojtjen e fëmijëve. Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës ka paraparë themelimin e linjës telefonike falas për ofrimin e ndihmës fëmijëve që kanë nevojë të këshillohen për të drejtat e tyre, si dhe për të raportuar rastet e dhunës, abuzimit, neglizhimit dhe trafikimit⁷⁴. Megjithatë, edhe pse Linja Telefonike është inicuar si proces nga Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit, Linja Telefonike falas nuk ka arritur të themelohet.

Legjislacioni⁷⁵ i obligon të gjithë zyrtarët dhe profesionistët që kanë për detyrë të kujdesen për fëmijët në sektorët e

shëndetësisë, arsimit dhe drejtësisë, të raportojnë dyshimet për dhunë në Qendrën për Punë Sociale respektive ose tek autoritetet policore të Kosovës. Përkundër obligimit ligjor, referimet nga këto institucione mbeten në shkallë të ulët sidomos në rastet e dhunës në shkolla. Sa i përket dhunës në shkolla, sipas Policisë së Kosovës, ka pasur rritje të madhe të incidenteve të dhunës në shkolla, krahasuar me vitet paraprake. Gjatë vitit 2022 janë raportuar gjithsej 592 raste të incidenteve në shkolla dhe përreth tyre.⁷⁶



GJITHSEJ 592

RASTE TË INCIDENTEVE NË SHKOLLA DHE PËRRETH TYRE

Protokolli për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar, është duke u zbatuar pjesërisht në mungesë të mbikëqyrjes. Kjo dëshmohet edhe nga numri shumë i vogël i rasteve të dhunës të raportuara në Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsim – SMIA, ku në vitin shkollor 2021/22 janë raportuar vetëm 39 raste të dhunës në shkolla.



VETËM 39

RASTE TË DHUNËS NË SHKOLLA JANË RAPORTUAR NË SMIA

Ndërkaq për vitin shkollor 2022/23 janë raportuar vetëm 44 raste.⁷⁷ Të dhënat nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit tregojnë se raportimet në Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsim – SMIA janë të vogla dhe

⁷⁰ Anketa e Treguesve të Shumëfshistë MICS 2020, Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe UNICEF, <https://askapi.rks-gov.net/Custom/08eb3166-e575-407a-a383-d959ead4088e.pdf>

⁷¹ Neni 63, Paragrafi 6, Edukimi për mbrojtjen e fëmijës, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës

⁷² Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë

⁷³ Të dhënat nga SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë, Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror

⁷⁴ Neni 22, paragrafi 4, Sistemi institucional formal dhe linja e telefonit për fëmijë, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës

⁷⁵ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës, Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare

⁷⁶ Të dhënat nga Policia e Kosovës, 2022

⁷⁷ Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, 2022

numri i shkollave raportuese është i vogël, duke konsideruar që nuk raportohen të gjitha rastet. Mospërputhja e madhe e të dhënave, jep indikacion që sistemi i parandalimit dhe trajtimit të dhunës brenda shkollave nuk është duke funksionuar.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka bërë disa përpjekje për rritjen e raportimit përmes shpërblimit të shkollave raportuese, megjithatë barrierat e raportimit ende vazhdojnë. Arsytet e mos raportimit lidhen me tendencën e udhëheqjes së shkollave për t'i mbajtur të izoluar rastet, për të ruajtur imazhin e shkollës si dhe në disa raste udhëheqësit e shkollave hezitojnë të raportojnë për shkak të kërcënimeve nga jashtë.

Në shumica shkolla të Kosovës është duke u praktikuar programi i ndërmjetësimit mes bashkëmohatarëve, i cili ka dhënë efekte pozitive në parandalimin e dhunës në shkolla dhe rritjen e raportimit. Deri në vitin 2022, 130 shkolla në 19 komuna kanë praktikuar programin e ndërmjetësimit.⁷⁸

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve viktimë të dhunës janë të qasshme si shërbime themelore në kuadër të Qendrave për Punë Sociale dhe strehimoreve. Gjatë vitit 2022, Qendrat për Punë Sociale kanë menaxhuar 523 raste të fëmijëve, viktimë të dhunës në familje të përfshirë në mënyrë direkte ose indirekte.⁷⁹



523 RASTE

TË FËMIJËVE VIKTIMA TË DHUNËS NË FAMILJE

Një pjesë e këtyre rasteve kanë përfitur nga shërbimet e ofruara nga 10 strehimoret për mbrojtjen nga dhuna të drejtuara nga sektori joqeveritar. 875 raste të dhunës në familje janë strehuar, trajtuar dhe kanë marrë shërbime rehabilitimi në strehimore (nëna dhe fëmijë). Gjatë strehimit dhe akomodimit, viktimave u janë ofruar shërbimet mjekësore, farmaceutike, psikologjike dhe sociale. Edhe pse financimi i shërbimeve të strehimoreve

nuk është rregulluar akoma që të jetë i qëndrueshëm, krahasuar me vitet paraprake, strehimoret kanë marrë mbështetje më të madhe me financimin e ofruar nga Ministria e Drejtësisë, e si rrjedhojë shërbimet kanë qenë të qëndrueshme dhe nuk ka pasur rrezik për mbylljen e këtyre shërbimeve, siç ka ndodhur në vitet më parë.⁸⁰

Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës parasheh nxjerrjen e një udhëzimi administrativ për themelimin e Shtëpive për Mbrojtjen e Fëmijës, megjithatë ky udhëzim nuk është nxjerrë dhe shtëpitë nuk janë themeluar.

Viteve të fundit ka pasur shqetësime rreth trajtimit nga institucionet të rasteve të veprave kundër integritetit seksual të fëmijëve sikurse dhunimi, sulmi seksual, degradimi i integritetit seksual dhe keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi. Veprat penale kundër integritetit seksual të fëmijëve janë duke ndodhur në ambiente si familje, komunitet, madje edhe në institucionet e mandatuara për mbrojtje të fëmijëve, si për shembull në institucione edukative, shkolla, etj.

Shoqëria civile ka shprehur indinjatën e thellë lidhur me krijimin e kulturës së mos ndëshkimit të kryerësve të veprave të krimeve seksuale kundrejt fëmijëve, e cila ka ndikuar në stimulimin e një mjedisi social të pasigurt, ku shkelja e të drejtave themelore të fëmijëve, cenimi i integritetit të tyre fizik, moral dhe seksual bëhet fenomen i zakonshëm e jo përjashtim. Ata kanë kërkuar mobilizim dhe llogaridhënie për mungesë performace në nivel të përgjegjësisë, së të gjithë akterëve të sistemit të mbrojtjes së fëmijës.

Me qëllim rritjen e vetëdijësimit për raportimin e dhunës, u zhvillua fushata "Shënimi i 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore" e udhëhequr nga Ministria e Drejtësisë, e cila kishte për fokus kryesisht dhunën ndaj vajzave.

Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës ka përcaktuar që Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të nxjerrë akt nënligjor për të përcaktuar rregullat dhe procedurat për mbajtjen e bazës së të dhënave me ADN-të e personave të dënues për veprat penale kundër integritetit seksual.⁸¹ Megjithatë, kjo nuk është realizuar.

Në Kosovë, aktualisht kemi një sistem të fragmentuar të mbrojtjes së fëmijëve. Për pasojë shërbimet në mes të sektorit të arsimit, mirëqenies dhe shëndetësisë nuk janë të integruara. Ndërhyrjet dhe shërbimet e institucioneve janë të izoluar, të pakoordinuara dhe nuk plotësojnë një ndër parimet bazë për trajtimin e dhunës, atë të qasjes multidisiplinare.⁸²

⁷⁸ Të dhënat nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe të dhënat nga organizata Qendra për Arsim e Kosovës, 2022

⁷⁹ Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë, 2022

⁸⁰ Të dhënat nga Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët dhe Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore - MVPT

⁸¹ Neni 58, paragrafi 2, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës

⁸² Qëndrimi për Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare, KOMF, https://komfosova.org/wp-content/uploads/2021/04/Qendrimi-LSHSF_alb_compressed.pdf

Rekomandime:

- » Krijimi dhe fuqizimi i programeve dhe shërbimeve parandaluese që kanë për qëllim mbështetjen e familjes, parandalimin e braktisjes së fëmijëve, parandalimin e ndarjes së fëmijëve nga prindërit adresimin e faktorëve të rrezikut të cilët mund të çojnë drejt humbjes së kujdesit familjar;
- » Zhvillimi dhe fuqizimi i shërbimeve në familje dhe shërbimeve me bazë në komunitet, zgjerimi i formave të mbrojtjes), konkretisht zhvillimi i strehimit familjar pas arritjes së moshës 18 vjeçare përmes zhvillimit të formës së re të mbrojtjes “Jetesa e pavarur e mbikëqyruar”;
- » Ofrimi i bursave për studime nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për fëmijët pa kujdes prindëror;
- » Rritja e numrit të familjeve strehuese dhe shtrirja e tyre në të gjitha komunat duke u bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, ku përcaktohet që çdo komunë duhet të ketë së paku 3 familje strehuese;
- » Ndërmarrja e veprimeve nga institucionet për ndryshimin e praktikës së dëmshme të mungesës së adoptimit të fëmijës mbi moshën 3 vjeç dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara si dhe vetëdijesimi i prindërve potencial adoptues;
- » Specializimi i familjeve strehuese sipas kategorive dhe ngritja e kapaciteteve të familjeve strehuese dhe prindërve potencial adoptues;
- » Kompensimi i familjeve strehuese me 50% të shumës gjatë kohës që nuk kanë fëmijë të strehuar;
- » Ofrimi i mbështetjes së vazhdueshme, realizimi ivizitave më të shpeshta dhe rehabilitimi sipas nevojës për fëmijët e vendosur në strehim familjar tek farefisi;
- » Intensifikimi i veprimeve parandaluese ndaj trafikimit me qenie njerëzore, duke zhvilluar fushata vetëdijesuese në të gjitha nivelet, përfshirë edhe fushatat me bazë në komunitet;
- » Themelimi dhe funksionalizimi i ekipeve mobile në të gjitha komunat për identifikim të fëmijëve në situatë rruge dhe fëmijëve të përfshirë në punë;
- » Themelimi dhe zhvillimi i shërbimeve për fëmijët e përfshirë në punë të rënda;
- » Hapja e qendrave ditore të specializuara për fëmijët e përfshirë në punë;
- » Fuqizimi i mekanizmave për identifikim dhe raportim të rasteve të trafikimit;
- » Zhvillimi dhe zbatimi i programeve për reintegrimin afatgjatë të fëmijëve që janë viktimat të trafikimit;
- » Financimi i qëndrueshëm i strehimeve që strehojnë dhe mbrojnë fëmijët viktimat të trafikimit;
- » Zbatimi i plotë i Strategjisë Kombëtare Kundër Trafikimit me Njerëz (2022 -2026);
- » Zbatimi i legjislacionit për mbrojtjen e fëmijëve, me fokus zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Protokollit për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Shkollë;
- » Miratimi dhe nxjerrja e të gjitha Udhëzimeve Administrative të paraparë në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës;
- » Themelimi dhe ofrimi i programeve dhe shërbimeve për prindërim të mirë, fuqizim të familjes dhe parandalim të dhunës në familje, për ngritjen e shkathësive dhe mbështetjen e prindërve në edukimin dhe mirërritjen e fëmijëve përmes formave pozitive të prindërimit;
- » Themelimi dhe aplikimi i programeve të dedikuara për fëmijët prej moshës së fëmijërisë së hershme. Programet duhet të kenë për qëllim njohjen e situatave dhe formave të dhunës, mos pranimit e dhunës, raportimin e rasteve të tilla, pranimit e diversitetit për parandalimin e bullizmit, etj;
- » Realizimi i aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimin e mësimeve dhe stafit arsimor në lidhje me parandalimin e dhunës dhe trajtimin e rasteve të saj;
- » Rritja e raportimit të rasteve të dhunës së fëmijëve të identifikuar nga institucionet publike;
- » Themelimi i linjës telefonike falas për mbrojtjen e fëmijës, i paraparë në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, për të lehtësuar dhe rritur raportimin e rasteve të dhunës, abuzimit, neglizhencës dhe trafikimit të fëmijëve;
- » Themelimi i shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve;
- » Krijimi i ambientit miqësor dhe përkrahës brenda shkollës, në mënyrë që problemi i dhunës të mos trajtohet vetëm me qasje reaktive, por të ketë koherencë të plotë në zhvillimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me parandalim, reagim dhe raportim;
- » Ndërhyrje dhe investim të menjëhershëm në themelimin dhe fuqizimin e shërbimeve të integruara edukative, psikologjike dhe sociale, me qëllim parandalimin e dhunës ndaj fëmijëve;
- » Sigurimi i financimit të qëndrueshëm për shërbimet sociale rezidenciale të ofruara nga strehimoret që strehojnë fëmijët viktimat të dhunës, si dhe organizatat që ofrojnë shërbime sociale në familje dhe komunitet me qëllim parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna;
- » Krijimi i data bazës së personave të dënuar për vepra penale kundër integritetit seksual të fëmijëve dhe rrjedhimisht ndalimin e qasjes së tyre tek fëmijët, sipas modeleve ekzistuese në hapësirën Europiane, duke u bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës;
- » Auditimi i trajtimit nga institucionet shtetërore të rasteve të dhunës seksuale ndaj fëmijëve, përfshirë trajtimin e kryerësve të veprave penale që kanë të bëjnë me dhunë seksuale, gjatë pesë viteve të fundit për të identifikuar problemet sistemore në trajtimin e rasteve të dhunës dhe adresimin e tyre;
- » Rritja e monitorimit dhe llogaridhënies së ofruesve të shërbimeve, me qëllim të parandalimit dhe trajtimit në kohë të rasteve të dhunës;
- » Rritja e ndërgjegjësimit publik përmes organizimit të fushatave vetëdijesuese që synojnë të sensibilizojnë opinionin publik në lidhje me pasojat e dhunës ndaj fëmijëve dhe promovimin e raportimit të rasteve të dhunës.



SHËNDETI

SHËNDETI


Nota: 2.25

- ▶ Mungesë e të dhënave statistikore lidhur me numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, numrin e fëmijëve që konsumojnë duhan, alkool dhe numrin e fëmijëve përdorues të drogave
- ▶ Mungesë e barnave në kujdesin parësor, sekondar dhe terciar shëndetësor
- ▶ Mungesë e shërbimeve parandaluese dhe shërbimeve rehabilituese të specializuara për trajtimin e fëmijëve përdorues të substancave narkotike
- ▶ Burime njerëzore shumë të kufizuara për shëndetin mendor të fëmijëve



31,420

lindje⁸³



Shkalla e mbulueshmërisë me vaksinat **91%** sipas kalendarit të vaksinimit të fëmijëve⁸⁴



Mesatarja e furnizimit me barna nga lista esenciale për vitin 2022 ishte **45%** në kujdesin parësor shëndetësor⁸⁵

117 RASTE

të vdekjes së foshnjave në vitin 2022⁸⁶

E drejta e fëmijës për trajtim shëndetësor është garantuar si me Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës, ashtu edhe me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës. Neni 42 i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës garanton kujdes shëndetësor falas për fëmijët, duke u mundësuar atyre të përfitojnë nga shërbimet e trajtimit të sëmundjeve dhe riaftësimin të shëndetit me standarde të larta. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë është e detyruar të sigurojë këtë të drejtë.⁸⁷

Në lidhje me të dhënat rreth shëndetit të fëmijëve, KOMF ka kërkuar të dhëna zyrtare nga Ministria e Shëndetësisë dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës, mirëpo nuk janë ofruar të dhëna për të gjitha fushat. Konkretisht, KOMF vlerëson se nuk ka të dhëna statistikore për vitet e fundit lidhur me gjidhënien, numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, numrin e fëmijëve që konsumojnë duhan, alkool dhe numrin e fëmijëve përdorues të

drogave, numrin e vizitave shëndetësore të fëmijëve në kujdesin privat shëndetësor, etj. Të dhënat e fundit për gjidhënien mbesin të dhënat e publikuara nga Anketa e Treguesve të Shumëfishtë – MICS, në vitin 2020.⁸⁸

KOMF vlerëson se për të përmbushur detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës, është i nevojshëm fillimi i një përpjekjeje për hulumtimin e dukurive që dëmtojnë shëndetin e fëmijëve dhe mbledhja e të dhënave të sakta për të gjitha shërbimet shëndetësore që ofrohen për fëmijët në Kosovë. Në veçanti, ka një mungesë të shprehur të të dhënave në lidhje me shërbimet shëndetësore të ofruara nga sektori privat, e cila pengon mbledhjen e të dhënave të sakta për shëndetin e fëmijëve dhe nevojat. Është shumë i rëndësishëm funksionalizimi i Sistemit të Informacionit Shëndetësor me qëllim grumbullimin e të dhënave për informimin shëndetësor dhe planifikimin e ndërhyrjeve bazuar në të dhëna.

⁸³ Të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2022

⁸⁴ Të dhënat nga Ministria e Shëndetësisë, 2022

⁸⁵ Të dhënat nga Ministria e Shëndetësisë, 2022

⁸⁶ Të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2022

⁸⁷ Neni 42, paragrafi 2, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës

⁸⁸ Anketa e Treguesve të Shumëfishtë MICS 2020, Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe UNICEF, <https://askapi.rks-gov.net/Custom/08eb3166-e575-407a-a383-d959ead4088e.pdf>

VDEKSHMËRIA E FOSHNJAVE

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në vitin 2022 në Kosovë janë regjistruar 31,420 lindje, prej tyre 22,632 lindje kanë ndodhur në Kosovë, kurse 8,788 lindje kanë ndodhur jashtë Kosovës.⁸⁹

Vdekshmëria e foshnjave në Kosovë, megjithëse është zvogëluar ndër vite, vazhdon të mbetet ende më e larta në krahasim me shtetet e rajonit.⁹⁰

Në vitin 2022, u regjistruan 117 raste të vdekjes së foshnjave.⁹¹ Raportet nga Reparti i Neonatologjisë tregojnë një rënie të shkallës së vdekshmërisë së foshnjave në të njëjtën periudhë, në krahasim me vitin 2021. Për vitin 2022, shkalla e vdekshmërisë ishte 14.4 promilë, një zvogëlim i ndjeshëm krahasuar me vitin e mëparshëm, ku kjo shifër ishte 18.6 promilë.⁹²

Ndër shkakuarët e vdekjeve të foshnjave në Kosovë janë shkaqet perinatale, prematuriteti me komplikime, anomalitë, komplekse të lindura dhe infeksionet.

Skriningu neonatal ende nuk aplikohet në vendin tonë. Skriningu neonatal është planifikuar të realizohet në planin e veprimit për shëndetin e nënës dhe fëmijës për vitet 2023 – 2025 i cili është finalizuar dhe pas përcaktimit të kostos financiare pritet të aprovohet.⁹³ Aktualisht, transporti neonatal i foshnjave nga spitalet rajonale në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës - QKUK realizohet në kushte jo adekuate dhe nga ekipe të cilat nuk janë mirë të përgatitura.

Realizimi i transportit neonatal nga spitalet rajonale në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës - QKUK si dhe ngritja e kapaciteteve të personelit shëndetësor për transportin neonatal, duhet të jetë një ndër prioritetet e vendosura e cila do të ndikojë në uljen e vdekjeve të foshnjave.

Në disa prej Qendrave të Mjekësisë Familjare në disa komuna, ka mungesë të gjinekologëve dhe pediatërve, kjo për shkak të shuarjes së pozitave të specialistëve në kujdesin parësor. Në raste të tilla pacientët kanë problem të shkojnë në komuna të mëdha për të marrë shërbimet gjinekologjike. Kjo sidomos është problematikë në zonat më të thella, siç është Komuna e Dragashit që aktualisht nuk ka gjinekolog dhe pacientet kanë problem të shkojnë për kontrolle shëndetësore në Komunën e Prizrenit.

IMUNIZIMI

Imunizimi i fëmijëve është një mjet kritik për kontrollin dhe eliminimin e sëmundjeve të rrezikshme për jetën. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) rekomandon që të gjitha foshnjat dhe fëmijët e vegjël të vaksinohen kundër tuberkulozit, difterisë, tetanozit, kollës së keqe, poliomielitit, fruthit, hepatitit B, Haemophilus influenzae tip B, sëmundjes pneumokokale, rotavirusit dhe rubeolës. Ky proces i vaksinimit ndihmon në ndalimin e përhapjes së këtyre sëmundjeve dhe ndihmon në ruajtjen e shëndetit të fëmijëve në mënyrë efikase.

Në Kosovë, është e obliguar që fëmijët të imunizohen kundër dhjetë sëmundjeve ngjithëse, që janë pjesë e Programit të Zgjeruar të Imunizimit (PZI). Këto janë sëmundje për të cilat ekzistojnë vaksina të detyrueshme ligjërish, dhe fëmijët vaksinohen në periudha kohore të caktuara sipas ligjit.

Sipas të dhënave nga Ministria e Shëndetësisë, shkalla e mbulueshmërisë me vaksinat arrin në 91%. Tabela në vijim shfaq të dhënat e mbulueshmërisë me vaksinat për vitet 2020, 2021 dhe 2022.⁹⁴ Arritje ishte zgjerimi i Kalendarit të vaksinimit me tre vaksina të reja për fëmijët, vaksina kundër rotavirusit, vaksina kundër pneumokokut e meningjitit dhe vaksina HPV, kundër kancerit të qafës së mitrës.

TABELA 5. Shkalla e përfshirjes me vaksinim (%), 2017-2022

ANTIGJENI	2020	2021	2022
BCG/HepB	94	92	93
DTP1/HepB1/Hib1	94	92	93
DTP2/HepB2/Hib2	91	89	92
DTP3/HepB3/Hib3	92	87	90
IPV1	94	92	93
IPV2	91	89	92
IPV3	92	87	90
MMR	90	85	88

⁸⁹ Të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2022

⁹⁰ Politika Rekomanduese për Shëndetin e Fëmijës, KOMF, <https://komfkosova.org/wp-content/uploads/2022/01/Politika-rekomanduese-Grupi-per-Shendetesi-1-1.pdf>

⁹¹ Të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2022

⁹² <https://kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/anetaret-e-komisionit-per-te-drejtat-e-njeriu-32171/>

⁹³ Të dhënat nga Ministria e Shëndetësisë, 2022

⁹⁴ Të dhënat nga Ministria e Shëndetësisë, 2022

Sa i përket përkujdesjes shëndetësore konstatohet diskrepancë e madhe në mes të fëmijëve që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe fëmijëve nga popullsia e përgjithshme.⁹⁵ Ministria e Shëndetësisë duhet të rishikojë strategjitë për përfshirjen e komuniteteve, me fokus tek shëndeti i nënave dhe fëmijëve p.sh. vizitat neonatale të shtatzënave, imunizimi tek fëmijët, ushqyerja e shëndetshme, kontrollet postnatale, etj.

GJIDHËNIA

Vitet e fundit, nuk ka të dhëna zyrtare të publikuara apo të qasshme për shkallën e gjidhënies në nivel vendi. Statistikë referuese vazhdojnë të mbesin të dhënat shqetësuese për gjidhënien të raportit Anketa e Treguesve të Shumëfishtë MICS 2020 të vitit 2020, ku vetëm 32% e të posalindurve ushqehen me gji brenda orës së parë pas lindjes, ndërsa të ushqyerit vetëm me gji është prevalent vetëm për 29% të fëmijëve nën moshën 6 muajsh, të dhëna këto që shfaqin nivel mjaft të ulët të ushqyerjes me gji. Ndërsa, vetëm 16% e fëmijëve nën moshën 6 muajshe nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë ushqehen vetëm me qumësht gjiri.

Ministria e Shëndetësisë ka zhvilluar tashmë programin e vizitave shëndetësore në shtëpi, me mbështetjen e donatorëve. Sipas të dhënave të ofruara nga Ministria e Shëndetësisë, këto vizita janë zhvilluar në 29 komuna deri më tani.⁹⁶ Këto vizita kanë për qëllim mbështetjen e praktikave të gjidhënies, të ushqyerit e shëndetshëm, identifikimin e problemeve shëndetësore tek fëmijët dhe përmirësimin e shëndetit të lehonave dhe të nënave.

Në disa prej komunave të Kosovës, në kuadër të Qendrave të Mjekësive Familjare janë hapur Klasat për Nëna dhe Fëmijë. Qëllimi i këtyre klasave është të ndikojë në përmirësimin e shëndetit të nënës dhe fëmijës përmes edukimit shëndetësor të nënave nga para-lindja deri tek procesi i pas-lindjes dhe kujdesit për fëmijën, duke ndikuar në zhvillimin në fëmijërinë e hershme. Aktualisht programi i Qendrave Informuese për Shëndetin e Gruas (QISHG – Klasat për nëna) funksionon në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike në Prishtinë dhe në Qendrat Kryesore të Mjekësive Familjare në 18 komuna. Ministria e Shëndetësisë bashkë me komunat duhet të zgjerojnë këtë program në të gjitha Komunat e Kosovës në mënyrë që të vetëdijesojnë

dhe edukojnë gratë dhe partnerët e tyre mbi shëndetin e nënës dhe fëmijës.

KUJDESI SPITALOR NË KLINIKËN E PEDIATRISË NË QENDRËN KLINIKE UNIVERSITARE TË KOSOVËS - QKUK

Lidhur me shërbimet shëndetësore publike për fëmijë, bazuar në të dhënat nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, Klinika e Pediatriisë ka raportuar se në vitin 2022 janë kryer 20,127 vizita ambulatorë, 20,861 vizita tjera diagnostike dhe 114 seanca dialize. Ndër këto, 7,124 fëmijë janë trajtuar në këtë klinikë, duke shkaktuar një mbingarkesë të dukshme. Kjo vjen si rezultat i numrit të kufizuar të shtrretërve, me vetëm 151 në dispozicion në Klinikën e Pediatriisë.⁹⁷ Bazuar në komunikimet me prindër dhe organizatat anëtare të KOMF, në këtë klinikë ka raste që dy fëmijë trajtohen në një shtrat për shkak të mungesës së hapësirës dhe kushteve.

Sa i përket personelit të punësuar në këtë klinikë, raportohet se përfshin 49 mjekë dhe 136 infermierë.⁹⁸ Ky numër i personelit është i pamjaftueshëm për të përmbushur të gjitha nevojat e fëmijëve në klinikën e Pediatriisë. Për shkak të kufizimeve në burime njerëzore, personeli shëndetësor është tejet i ngarkuar në ofrim të shërbimeve shëndetësore për fëmijët. Kjo bën që cilësia e shërbimeve shëndetësore për fëmijët të ulet.

Funksionalizimi i spitalit të ri kirurgjik-pediatrik ka përmirësuar përkujdesin shëndetësor të fëmijëve në nivel terciar. Spitali ka integruar shërbimet e emergjencave pediatrike mjekësore, ato të traumës, shërbimet e rikuperimit, ambulancave specialistike, pediatrike dhe kirurgjike e të tjerë. Megjithatë duke parë mbingarkesën dhe numrin e vogël të stafit, rritja e burimeve njerëzore dhe riorganizimi i punës është i domosdoshëm.

⁹⁵ Anketa e Treguesve të Shumëfishtë MICS 2020, Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe UNICEF, <https://askapi.rks-gov.net/Custom/08eb3166-e575-407a-a383-d959ead4088e.pdf>

⁹⁶ Të dhënat nga Ministria e Shëndetësisë, 2022

⁹⁷ <https://shskuk.rks-gov.net/Navbar/SingleNeës/17764>

⁹⁸ Të dhënat nga Klinika e Pediatriisë, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, 2022

FURNIZIMI ME BARNA NGA LISTA E BARNAVE ESENCIALE

Edhe pse Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës garanton kujdesin shëndetësor falas, në vazhdimësi është raportuar për mungesë të barnave dhe materialeve të tjera në kujdesin parësor shëndetësor, spitalet rajonale dhe në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës – QKUK.⁹⁹

Mungesa e terapisë së nevojshme për fëmijët në nevojë për terapinë përkatëse, mund të sjellë pasoja për shëndetin e fëmijëve. Sa i përket mungesës së barnave, në mungesë të tyre, prindërit detyrohen t'i blejnë nga xhepi i tyre barnat nga lista esenciale.¹⁰⁰

Lidhur me nivelin e furnizimit me barna nga Lista e Barnave Esenciale në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës – QKUK, Ministria e Shëndetësisë nuk ka ofruar të dhëna. Megjithatë, mungesa e barnave nga Lista e Barnave Esenciale është raportuar në vazhdimësi nga mediat por edhe nga vetë prindërit, të cilët janë detyruar t'i blejnë barnat e nevojshme pavarësisht gjendjes së tyre ekonomike.

Sa i përket furnizimit me barna nga Lista Esenciale në kujdesin parësor shëndetësor, mesatarja e furnizimit me barna nga lista esenciale për vitin 2022 ishte 45%, ndërsa mesatarja e furnizimit me material shpenzues për vitin 2022 ishte 71.71 %.¹⁰¹

	KOMUNA	FURNIZIMI ME BARNA ESENCIALE%	FURNIZIMI ME MATERIAL SHPENZUES%
1	Deçan	36.88	71.22
2	Dragash	45.05	64.50
3	Drenas	38.34	72.43
4	Ferizaj	28.70	66.44
5	Fushë Kosovë	36.83	72.25
6	Gjakovë	50.00	70.00
7	Gjilan	42.28	80.34
8	Hani i Elezit	40.49	65.93
9	Istog	36.50	50.00
10	Kaçanik	60.00	90.00
11	Kamenicë	46.00	70.00
12	Klinë	40.43	77.23
13	Malishevë	40.42	81.08
14	Mamushë	55.00	90.00
15	Mitrovicë E. J.	54.75	91.00
16	Novobërdë	30.00	40.00
17	Obiliq	60.00	80.00
18	Pejë	55.10	70.20
19	Partesh	65.00	35.00
20	Podujevë	43.00	80.00
21	Prishtinë	32.00	76.00
22	Prizren	40.74	79.05
23	Rahovec	40.00	55.00
24	Ranillug	65.00	80.00
25	Shtërpcë	51.00	72.00
26	Skënderaj	40.50	64.40
27	Suharekë	60.00	80.00
28	Vushtrri	40.99	81.85
29	Viti	30.14	73.89
		BARNA	MATERIAL SHPENZUES
	MESATARJA	45.00	71.71

⁹⁹ Raportimet në media

¹⁰⁰ Politika Rekomanduese për Shëndetin e Fëmijës, KOMF, <https://komfkosova.org/wp-content/uploads/2022/01/Politika-rekomanduese-Grupi-per-Shendetesi-1-1.pdf>

¹⁰¹ Të dhënat nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, 2022

Në kategorinë e barnave komunat të cilat kanë raportuar furnizim më të ulët janë: Ferizaj 28.7 %, Novobërda 30%, Vitia 31.04% dhe Prishtina me 32%. Furnizimin më të lartë e kanë raportuar komunat Ranillug dhe Partesh me nga 65%, si dhe Suhareka, Kaçaniku dhe Obiliqi me furnizim prej 60 %.¹⁰²

Sa i përket materialit shpenzues komunat me furnizim më të ulët të raportuar janë: Parteshi 35%, Novobërda 40 % dhe Istogu 50%. Furnizimin më të lartë në këtë kategori e kanë raportuar komunat: Mitrovicë e Jugut 91%, Mamushë 90% dhe Kaçanik 90%.¹⁰³

Jashtëzakonisht shqetësuese mbetet edhe mungesa e barnave nga lista esenciale pa të cilat fëmijët nuk mund të mbijetojnë. Me medikamentin surfakant pa të cilin foshnjat e lindura para kohe mund të vdesin, ka probleme të herëpashershme sa i përket furnizimit të rregullt. Prej vitesh tashmë, medikamentin surfakant e siguron organizata anëtare e KOMF, Aksioni për Nënë dhe Fëmijë për Klinikën e Neonatologjisë. Mirëpo, në raste të caktuara ka periudha që mbesin të pambuluara me furnizim me këtë medikament dhe si pasojë Klinika e Neonatologjisë mbetet pa të, duke rrezikuar seriozisht jetët e foshnjave të lindura para kohe. Medikamenti surfakant nuk është në kuadër të Listës së Barnave Esenciale. KOMF ka propozuar që edhe medikamentet që sigurohen nga donatorët, të përfshihen në një përqindje të caktuar në kuadër të Listës së Barnave Esenciale, në mënyrë që mos të ketë mungesa. Për shembull, në rastin e barit surfakant, 90% të sigurohet nga donatorët dhe 10% të sigurohet përmes Listës së Barnave Esenciale.

Po ashtu, mbetet problematike mos furnizimi me terapi nga Lista e Barnave Esenciale për fëmijët me fibrozë cistike, e cila hyn tek sëmundjet e rralla. Prindërit kanë shprehur shqetësimin që kanë shumë vështirësi në sigurimin e terapisë për fëmijët e tyre me fibrozë cistike.¹⁰⁴

Buxheti i ndarë për shëndetësinë për vitin 2022 ishte 198 milionë Euro, ndërsa për Listën e Barnave Esenciale dhe programeve specifike, buxheti i ndarë ishte 11.2 milionë Euro.

¹⁰² Të dhënat nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, 2022

¹⁰³ Të dhënat nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, 2022

¹⁰⁴ Politika për Shëndetin e Fëmijës, KOMF, <https://komfkosova.org/wp-content/uploads/2022/01/Politika-rekomanduese-Grupi-per-Shendetesi-1-1.pdf>

¹⁰⁵ Të dhënat nga organizata Labyrinth


¹⁰⁶ Të dhënat nga organizata Labyrinth

LIGJI PËR SIGURIME SHËNDETËSORE

Investimet në sektorin e shëndetësisë në Kosovë janë të ulëta. Një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve nuk kanë qasje të mjaftueshme në kujdesin shëndetësor për shkak të pagesave të larta për ilaçe, nga xhepi i tyre. Kjo është akoma më problematike, duke patur parasysh që 22% e fëmijëve në Kosovë jetojnë në varfëri, përdherisa 7% prej tyre, jetojnë në varfëri ekstreme. Edhe pse Ligji Nr. 04/L-249 për Sigurime Shëndetësore është miratuar në vitin 2014, ky ligj asnjëherë nuk ka hyrë në fuqi. Në Planin Legjislativ të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës për vitin 2021, është paraparë që Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-249 për Sigurime Shëndetësore, të bëhet deri më 30 Nëntor 2021. Kjo ka ndodhur dhe ky Projektligj është shtyrë por ky ligj nuk është miratuar. Sipas Anketës së Treguesve të Shumëfishtë MICS 2020, përqindja e fëmijëve e mbuluar nga ndonjë sigurim shëndetësor ishte 5.6% për fëmijët nën 5 vjeç dhe 3.6% për fëmijët mbi 5 vjeç.

PËRDORIMI I SUBSTANCAVE NARKOTIKE NGA FËMIJËT

Kosova përballet me sfida të shumta në parandalimin dhe trajtimin e fëmijëve viktime të abuzimit me narkotikë. Viteve të fundit, vlerësohet se numri i përgjithshëm i përdoruesve ka kaluar për herë të parë shifrën prej 30 000 ndërkohë që fëmijët dhe adoleshentët përdorues vazhdojnë të bëjnë pjesë çdo vit e më shumë në këtë shifër.¹⁰⁵



MOSHA MESATARE E FILLIMIT TË PËRDORIMIT TË DROGAVE KA RËNË NË 16 VJEÇ

Bazuar në bazën e të dhënave të Labyrinth, mosha mesatare e fillimit të përdorimit të drogave ka rënë nga 18 vjeç në vitin 2018, në 16 vjeç në periudhën e fundit. Sipas Labyrinth, në bazë të kërkesave për trajtim dhe punës së vazhdueshme në terren vlerësohet se në Kosovë janë rreth 35 000 përdorues aktiv të drogave. 2885 përdorues marrin trajtim të thellë në Qendrën Labyrinth. Ndërkaq, rreth 3000 përdorues të drogave nuk dëshirojnë të identifikohen, prandaj nuk regjistrohen në databazë.¹⁰⁶ Megjithatë të dhënat e mësipërme përfshijnë të gjithë përdoruesit dhe nuk ka një vlerësim të saktë se sa prej tyre janë fëmijë.

Qendra Labirinth mbetet organizata e vetme e licensuar në Kosovë nga Ministria e Shëndetësisë për ofrimin e shërbimeve rehabilituese për përdoruesit e drogave fëmijë dhe të rritur.

Është shqetësues fakti që ka një rritje të përdorimit të drogave tek të rinjtë. Moshë mesatare e përdoruesve është rreth 27 vjeç, duke treguar se grup moshat më të reja janë më të prekura. Sipas Policisë së Kosovës gjatë vitit 2022, të ngarkuar me veprën penale 'Blerja, posedimi, shitja dhe shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 i Kodi Penal i Republikës së Kosovës, dhe vepra penale 'Posedimi, i paautorizuar i sub. narkotike, psikotrope ose analoge' nga neni 269, nga grup moshat 14 - 18 vjeç ishin gjithsej 56 fëmijë, ku nga ta 55 fëmijë kanë qenë meshkuj ndërsa 1 femër, (mosha më e re e regjistruar tek përdoruesit ka qenë mosha 14 vjeç, 1 person).¹⁰⁷

Marihuana vazhdon të jetë substanca më e përdorur në Kosovë. Përderisa deri në vitin 2018 ka pasur një një ulje të përdorimit të heroinës tek popullata e përgjithshme, gjatë katër viteve të fundit vërehet një rritje e lehtë e përdoruesve të heroinës në veçanti të komunitet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, ndërsa ka një rritje të shpejtë dhe shumë të madhe të përdorimit të kokainës të popullata e përgjithshme. Drogat stimulante si ekstazi, mdma, amfetamina, ghb, lsd, etj, janë të pranishme gjithashtu, por nuk ka ndonjë trend të dukshëm të rritjes së përdorimit apo qarkullimit të drogave të reja në treg (NPS - New Psychoactive Substances).¹⁰⁸

Arsyet pse fëmijët fillojnë të përdorin droga janë të shumta, përfshirë disponueshmërinë e drogave në treg, traumën e fëmijërisë së hershme, mungesën e informacionit mbi rreziqet e përdorimit të drogave, presionin shoqëror dhe kureshtjen për të provuar gjëra të reja, etj. Përdorimi i drogave sjell pasoja të dëmshme për fëmijën, familjen, shoqërinë dhe shtetin, duke përfshirë: dëmtimin e shëndetit fizik dhe psikologjik, problemet sociale, kriminalitetin, shpenzimet financiare të mëdha dhe dëmet afatgjata tek fëmija, familja dhe shoqëria.

Vendi ynë vazhdon të mos sigurojë shërbime dhe programe të strukturuar dhe të qëndrueshme parandaluese të cilat janë më se të nevojshme duke parë trendet në rritje të përdorimit të drogave nga fëmijët dhe adoleshentët. Përjashtim bën Policia e Kosovës, e cila ka programin vjetor të ligjëratave në parandalim dhe vetëdijesim të dukurive, ku është e përfshirë edhe tema lidhur me parandalimin e substancave narkotike. Në vitin 2022 janë mbajtur ligjëratat në 108 shkolla me pjesëmarrjen e 5624 nxënësve.¹⁰⁹ Duke pasur parasysh se numri i nxënësve në Kosovë është 327,676 nxënës/e, konstatohet se programet për parandalimin e

substancave narkotike nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar nevojat.

Për të adresuar këtë situatë, është e rëndësishme që autoritetet të ndërmarrin hapa të menjëhershëm për të rritur ndërgjegjësimin mbi rrezikun e përdorimit të drogave, si dhe të zhvillojnë programe të strukturuar për parandalimin dhe trajtimin e abuzimit të drogave në Kosovë. Gjithashtu, vëmendja duhet të përqendrohet në të rinj dhe adoleshentë për të shmangur fillimin e tyre të hershëm me përdorimin e drogave. Kosova nuk ofron mjaftueshëm shërbime të qasshme për identifikimin e fëmijëve që janë viktimat të abuzimit me narkotikë. Ka mungesë të shërbimeve dhe ekipeve mobile në komunitet që do të mundësonin testimin dhe identifikimin e rasteve të mundshme të fëmijëve që përdorin substancat narkotike.

Në këtë drejtim, shqetësuese ishte edhe mungesa e testeve për detektim të drogave në organizëm. Deri në vitin 2020, është lejuar blerja dhe administrimi me teste rapide për detektim të drogave në organizëm siç janë testi për Opiate dhe për Metadon, mjete këto që kanë shërbyer si instrument biologjik për vlerësim të pranishmërisë së drogave në organizëm dhe trajtim të personave përdorues të substancave narkotike. Ky problem tashmë është rregulluar nga Ministria e Shëndetësisë dhe testet rapide janë përfshirë në kuadër të Listës Esenciale të Barnave¹¹⁰

Kosova nuk ofron shërbime të veçanta të rehabilitimit për fëmijët viktimat të abuzimit me narkotikë. Shërbimet ekzistuese ofrohen në kuadër të trajtimit të të rriturve që përdorin narkotikë. Klinika Psikiatrike e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës ka improvizuar një repart të posaçëm për trajtimin e varësisë por ky repart është i dedikuar për pacientët e rritur, edhe pse ai trajton edhe fëmijët duke qenë se nuk ekziston asnjë objekt tjetër në dispozicion ose repart i veçantë për fëmijët. Kjo njësi nuk është e përshtatshme për fëmijët dhe nuk është mjedis miqësor dhe i sigurtë për ta. Trajtimi shëndetësor në QKUK bazohet në programet e detoksimit ku përdoren barna nga Lista e Barnave Esenciale. Në vitin 2022, ky repart ka trajtuar 7 fëmijë përdorues nën moshën 18 vjeçare.

Në përgjithësi profesionistët ndeshen me sfida të mëdha në trajtimin e fëmijëve që janë viktimat të abuzimit me droga. Ata nuk disponojnë burimet e nevojshme, duke përfshirë ekipe multidisiplinare, reparte të posaçme për fëmijë, për zbatimin e planeve dhe programeve të specializuara për rehabilitim. Profesionistët nuk kanë burimet e nevojshme për të mbështetur prindërit ose kujdestarët në trajtimin dhe mbështetjen e fëmijëve të tyre që janë viktimat të abuzimit me droga. Kjo mungesë e burimeve dhe shërbimeve bën që

¹⁰⁷ Të dhënat nga Policia e Kosovës, 2022

¹⁰⁸ Të dhënat nga organizata Labirinth

¹⁰⁹ Të dhënat nga Policia e Kosovës, 2022

¹¹⁰ Të dhënat nga organizata Labirinth

prindërit dhe kujdestarët të ndihen të papërgatitur në luftën kundër abuzimit me droga të fëmijëve të tyre.

Aktualisht, Ministria e Shëndetësisë dhe komunat nuk kanë zhvilluar një skemë të qëndrueshme për blerjen e shërbimeve nga sektori joqeveritar dhe privat. Mbështetja nga MSH dhe komunat bëhet përmes subvencionimit në kohë të shkurtër kohore dhe buxhet të pamjaftueshëm, e cila nuk konsiderohet si formë e përshtatshme dhe e qëndrueshme për financimin e shërbimeve dhe programeve.

Mangësia tjetër e sistemit ka të bëjë me mungesën e statistikave të sakta në nivel nacional mbi numrin e fëmijëve përdorues të drogave.

Si përfundim ka nevojë për zhvillimin e programeve të parandalimit si dhe krijimin e shërbimeve dhe qendrave të posaçme të specializuara për trajtimin e fëmijëve dhe të rinjve përdorues të drogave. Gjithashtu, është e rëndësishme të zhvillohen programe për fuqizimin e prindërve të fëmijëve përdorues të drogave për të rritur kapacitetet e tyre për kujdesin ndaj fëmijëve përdorues të drogave.

SHËNDETI MENDOR I FËMIJËVE

Shëndeti mendor i fëmijëve është sfidë e madhe sidomos pas pandemisë Covid-19, sidomos duke patur parasysh numrin e vogël të burimeve dhe shërbimeve në dispozicion.

Më qëllim të ruajtjes së mirëqenies së plotë fizike dhe mendore, Ministria e Shëndetësisë miratoi Planin e veprimit për shëndet mendor pas pandemisë COVID-19.

Në kuadër të shërbimeve të shëndetit mendor në Kosovë operojnë këto klinika¹¹¹: Klinika e Psikiatrisë në Shërbimin Spitalor Universitar i Kosovës, Reparti i Psikiatrisë i Spitalit të Përgjithshëm në Gjakovë, Reparti i Psikiatrisë i Spitalit të Përgjithshëm në Pejë, Reparti i Psikiatrisë i Spitalit të Përgjithshëm në Gjilan, Reparti i Psikiatrisë në Prizren dhe Qendrat e Shëndetit Mendor në Prishtinë, Mitrovicë, Prizren, Pejë, Gjilan, Ferizaj dhe Gjakovë.

Sa i përket burimeve njerëzore, në nivel vendi në institucionet publike shëndetësore janë të punësuar 52 psikiatër, prej të cilëve 45 psikiatër për të rritur dhe vetëm 7 psikiatër për fëmijë dhe adoleshentë në nivel të gjithë vendit.



VETËM 7 PSIKIATËR PËR FËMIJË DHE ADOLESHENTË NË NIVEL TË KOSOVËS

¹¹¹ <https://shendetimendor.uni-pr.edu/hospitalList.html>

¹¹² Të dhënat nga Plani i Veprimit i Shëndetit Mendor pas Pandemisë Covid-19

¹¹³ Të dhënat nga Njësia e Shëndetit Mendor për Fëmijë dhe Adoleshentë të Qendrës së Shëndetit Mendor në Prizren

¹¹⁴ Të dhënat nga Reparti i Psikiatrisë në Spitalin e Prizrenit, 2022

Po ashtu janë 10 specialistë të psikologjisë klinike, 2 psikologë klinik, 7 punëtorë social dhe 2 këshilltarë psikosocial, që zhvillojnë veprimtarinë në nivelin dytësor dhe tretësor shëndetësor, si dhe 217 infermierë.¹¹² Të dhënat se vetëm 7 psikiatër për fëmijë janë të punësuar në institucionet publike shëndetësore në nivel vendi si dhe numri i psikologëve klinik, janë të dhëna shumë shqetësuese kur flasim për burimet në dispozicion në institucionet publike për shëndetin e fëmijëve.

Në kuadër të sektorit privat të shërbimeve shëndetësore, ekziston një numër i konsiderueshëm i shërbimeve psikiatrike dhe psikologjike, megjithatë nuk ka të dhëna për numrin e fëmijëve të trajtuar në shërbimet e sektorit privat.

Numri i kërkesave nga fëmijët për shërbime të shëndetit mendor është rritur sidomos pas pandemisë Covid-19, përderisa numri i profesionistëve të shëndetit mendor është tejet i kufizuar për të përballuar kërkesat dhe për ofruar shërbime cilësore. Në Njësinë e Shëndetit Mendor për Fëmijë dhe Adoleshentë të Qendrës së Shëndetit Mendor në Prizren, gjatë vitit 2022, është regjistruar një numër i madh i kërkesave për trajtim të fëmijëve dhe adoleshentëve me probleme të shëndetit mendor. Në total, janë raportuar 531 raste të fëmijëve dhe adoleshentëve të cilët kanë kërkuar ndihmë në këtë njësi shëndetësore. Në këtë njësi janë ofruar shërbimet sikurse: vizita psikiatrike dhe vizita shtëpiake, aktivitete psiko edukative, psikoterapia familjare, psikoterapia individuale dhe terapi medikamentoze.¹¹³ Në këtë njësi ka programe dhe shërbime të veçanta për fuqizimin e prindërve dhe familjeve të fëmijëve përdorues të drogave të cilat janë: Psikoedukimi familjar dhe Psikoterapia familjare, ku 21 adoleshentë dhe familjet e tyre kanë përfituar nga këto programe gjatë vitit 2022. Sa i përket burimeve njerëzore, në Njësinë e Shëndetit Mendor për Fëmijë dhe Adoleshentë të Prizrenit punon vetëm një psikiatër për fëmijë dhe adoleshentë dhe një infermiere. Duke marrë parasysh numrin e rasteve të fëmijëve prej 531 gjatë 2022 dhe shërbimet e ofruara në këtë njësi, në raport me numrin e burimeve njerëzore, konkretisht një psikiatër të vetëm që operon në këtë njësi, konstatohet mbingarkesë e madhe e cila cenon cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Ndërsa, në Repartin e Psikiatrisë në Spitalin e Prizrenit, në vitin 2022 janë raportuar 103 raste të vizitave ambulatoriale specialiste për fëmijët me probleme të shëndetit mendor. Gjithashtu, ka patur 7 raste të hospitalizimit, ku 3 nga këto raste kanë qenë përdorues të drogave, ku janë trajtuar në mënyrë hospitalore dhe janë përfshirë në procesin e detoksikimit nga substancat psikoaktive. Në total, stafi në Repartin e Psikiatrisë në Spitalin e Prizrenit përfshin 5 mjekë specialistë të psikiatrisë dhe 11 infermierë. Ky staf trajton pacientët të rritur dhe fëmijë me probleme të shëndetit mendor dhe për rastet e detoksikimit. Në këtë repart, mesatarisht është ofruar vetëm nga një shërbim pasi që rastet janë adresuar te psikiatri i fëmijëve dhe adoleshentëve në Qendrën e Shëndetit Mendor në Prizren për trajtimin vijues.¹¹⁴

Në Repartin e Psikiatrisë në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës, gjatë vitit 2022, janë raportuar 335 raste të fëmijëve deri në 18 vjeç që kanë kërkuar trajtim për probleme të shëndetit mendor. Në Njësinë e Varësisë, në Repartin e Psikiatrisë të Spitalit të Përgjithshëm të Gjakovës, janë trajtuar 9 raste të fëmijëve gjatë vitit 2022. Prej tyre, 2 raste janë lajmëruar për trajtim nga Qendra për Punë Sociale, ndërsa 4 të mitur janë referuar nga Shërbimi Sprovues i Kosovës për të marrë seanca të këshillimit psikologjik. Në Repartin Psikiatrik të Spitalit të Përgjithshëm të Gjakovës punojnë 5 psikiatër. Një psikiatër është i specializuar për trajtimin e rasteve të abuzimit me substanca, një tjetër psikiatër është specializuar për fëmijët, ndërsa një tjetër është me edukim të veçantë në psikoterapi familjare. Përveç kësaj, ka edhe 2 psikiatër të përgjithshëm që ofrojnë trajtim për rastet e përgjithshme të shëndetit mendor. Ky staf i specializuar është i rëndësishëm për sigurimin e kujdesit të përshtatshëm dhe të personalizuar për fëmijët me probleme të shëndetit mendor.¹¹⁵

PIRJA E DUHANIT, ALKOOLIT, PIJEVE ENERGIKE, NARGJILEVE DHE CIGAREVE ELEKTRONIKE (VAPE)

Fëmijët në Kosovë janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të lidhura me pirjen e duhanit, qofshin ato aktive ose pasive. Fëmijët që ndodhen në ambiente ku pihet duhani, si në familje apo ambiente të tjera të mbyllura, kanë një rrezik më të lartë për infeksione dhe sëmundje të mushkërive, duke përfshirë bronkitin, pneumoninë dhe sëmundjet kardiovaskulare. Edhe pse në vitin 2008, Kosova miratoi Ligjin për Kontrollin e Duhanit, ky ligj nuk po arrin të zbatohet. Ligji i Duhanit nuk respektohet në biznese të ndryshme, duke përfshirë edhe bizneset e gastronomisë pranë shkollave, që frekuentohen rregullisht nga fëmijët.

Konsumimi i pijeve energjike është një tjetër shqetësim i rëndësishëm për shëndetin e fëmijëve në Kosovë. Tregu i këtyre produkteve në Kosovë është shumë i gjerë dhe ato shiten kudo, pa marrë parasysh moshën e personit. Pijet energjike përmbajnë kafeinë dhe stimulues të zemrës, të cilat jo vetëm që nuk janë të nevojshme për fëmijët, por janë të dëmshme dhe mund të ndikojnë në ritmin e zemrës dhe të shkaktojnë probleme të tjera shëndetësore.

Në Kosovë ende nuk ka një bazë ligjore për ndalimin dhe sanksionimin e shitjes dhe përdorimit të pijeve energjike tek fëmijët. Madje, nuk është finalizuar dhe aprovuar Ligji që do të rregullojë konsumimin e këtyre pijeve, duke përfshirë edhe ato me sasi të lartë të sheqerit. Përkundër hapave të ndërmarrë në këtë drejtim, duke përfshirë formimin e një grupi punues nga Komisioni Parlamentar për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim për hartimin e këtij ligji, ende nuk ka arritur të përfundojë një draft ligji dhe të aprovohet.

Në Kosovë, ende nuk ka një bazë ligjore që rregullon konsumimin e nargjileve dhe cigareve elektronike, të njohura ndryshe si “vape”. Kjo mungesë e ligjit ka shqetësuar vazhdimisht prindërit, të cilët shpesh kanë ngritur zërin për sigurinë e fëmijëve të tyre. Këshilli i Prindërve të Kosovës e ka vlerësuar këtë si një dukuri shqetësuese dhe ka bërë thirrje për të ndërmarrë masa urgjente për të parandaluar përdorimin e cigareve elektronike, duke qenë se pasojat e mundshme janë serioze. Deri tani, organet e vendit nuk kanë ndërmarrë hapa për të rregulluar këtë çështje dhe ndaluar shitjen e këtyre produkteve tek fëmijët.

Gjithashtu, është shqetësuese edhe mungesa e rregullimit ligjor në kuadër të Kodit Penal të Kosovës që ndëshkon shitjen dhe shërbimin e pijeve alkoolike për personat nën moshën 16 vjeç. Në legjislacionin e Kosovës, fëmijët konsiderohen personat deri në moshën 18 vjeç, kështu që kjo bie ndesh me rregullimin ligjor që përcakton fëmijët në Kosovë si dhe privon mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve nga përdorimi i substancave të dëmshme.

Rekomandime

- ▶ Realizimi i skringut apo “screening test” tek të posalindurit në institucionet publike dhe private shëndetësore për diagnostikim të hershëm të sëmundjeve potenciale;
- ▶ Realizimi i transportit neonatal nga spitalet rajonale në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës – QKUK si dhe ngritja e kapaciteteve të personelit shëndetësor për transportin neonatal. Kjo do të ndikojë në uljen e vdekjeve të foshnjave të cilat aktualisht transportohen nga ekupe jo mirë të përgatitura dhe në kushte jo adekuate;
- ▶ Intensifikimi i programit të vizitave në shtëpi nga Qendrat e Mjekësisë Familjare në të gjitha komunat e Kosovës, për të mundësuar vaksinimin në shtëpi (vaksinimin derë më derë), mbështetjen e praktikave të gjidhënies, të ushqyerit e shëndetshëm si dhe identifikimin e problemeve shëndetësore tek fëmijët, duke kontribuar kështu drejtpërdrejtë në shëndetin dhe zhvillimin e fëmijëve;
- ▶ Zgjerimi dhe promovimi i modelit të Qendrave Informuese për Shëndetin e Gruas (QIShG – Klasat për nëna) për të promovuar edukimin shëndetësor, shëndetin e nënave gjatë shtatzënisë, gjidhënien, vaksinimin dhe rritjen e shëndetshme;

¹¹⁵Të dhënat nga Reparti i Psikiatrisë në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës, 2022

- ▶ Ofrimi i shërbimeve gjinekologjike të paktën një herë në javë tek komunitet e zonave më të thella për pacientet në qendrat e kujdesit parësor. Për shembull, gjinekologu nga Komuna e Prizrenit, një herë në javë të vizitojë Qendrën e Mjekësisë Familjare në Dragash për të ofruar shërbime për gratë paciente;
- ▶ Ministria e Shëndetësisë duhet të propozojë ndryshimet ligjore drejt Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, duke paraparë masa ndëshkuese për prindërit të cilët neglizhojnë dhe refuzojnë vaksinimin e fëmijëve. Modele të tilla mund të merren nga shtetet e Bashkimit Europian, ku mos-vaksinimi i fëmijëve nga prindërit cilësohet si neglizhim shëndetësor dhe dënohet me gjobë. Gjithashtu, rekomandohet vendosja e vaksinimit të fëmijëve si kusht për regjistrim në shkollë dhe si kriter në kuadër të Ligjit të ri 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale, i cili është në proces të plotësim-ndryshimit;
- ▶ Rritja e numrit të personelit shëndetësor në Klinikën e Pediatrisë me qëllim të ofrimit të shërbimeve më cilësore për fëmijët;
- ▶ Informimi, ndërgjegjësimi dhe edukimi shëndetësor përmes fushatave për përmirësimin e praktikave shëndetësore, planifikim familjar, shëndetin riprodhues dhe marrjen e shërbimeve shëndetësore;
- ▶ Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm me barna në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës – QKUK, spitalet rajonale dhe kujdesin shëndetësor parësor, për të garantuar që barnat esenciale të mos mungojnë asnjëherë;
- ▶ Rishikimi i Listës së Barnave Esenciale, për të përfshirë surfakantin dhe medikamentet për trajtimin e sëmundjeve të rralla;
- ▶ Zhvillimi i masave dhe programeve për parandalimin e përdorimit të drogave nga fëmijët. Organizimi i ekipeve mobile në komunitet për identifikim, testim dhe mbështetje të rasteve të fëmijëve viktime të abuzimit me droga;
- ▶ Fuqizimi i shërbimeve të trajtimit dhe rehabilitimit në kuadër të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe spitaleve rajonale përmes krijimit të njësive të veçanta apo qendrave të specializuara vetëm për fëmijët përdorues të drogave. Këto njësi duhet të ofrojnë ambiente miqësore dhe të sigurta për trajtimin e fëmijëve përdorues të drogave;
- ▶ Zhvillimi i programeve për fuqizimin e prindërve për të rritur kapacitetet e prindërve për kujdesin dhe mbështetjen e fëmijëve gjatë rehabilitimit dhe re-integrimit;
- ▶ Rritja e burimeve njerëzore brenda institucioneve publike shëndetësore për shëndetin mendor, rritja e numrit të psikiatërve, psikologëve dhe punëtorëve social për fëmijë;
- ▶ Krijimi i mekanizmave të qëndrueshëm për mbledhjen e të dhënave në nivel komunal dhe qendror në mënyrë që të gjenerojnë të dhëna të sakta dhe të qëndrueshme për numrin e fëmijëve viktime të abuzimit me narkotikë, moshën, statusin ekonomik, llojet e drogave, etj. Këto dhëna do të ndihmonin në një planifikim më adekuat të programeve dhe shërbimeve përkatëse;
- ▶ Rritja e monitorimit dhe inspektimit të pirjes së duhanit në të gjitha ambientet e ndaluara me ligj;
- ▶ Zhvillimi apo sponsorizimi i fushatave vetëdijësuese për ndërgjegjësimin e masës për dëmet që shkakton konsumimi i duhanit, alkoolit, pijeve energjike, nargjileve dhe cigareve elektronike;
- ▶ Rregullimi i kornizës ligjore që ndalon shitjen dhe konsumimin e alkoolit për personat nën moshën 18 vjeç;
- ▶ Zhvillimi apo miratimi i kornizës ligjore që ndalon shitjen dhe konsumimin e pijeve energjike, nargjileve dhe cigareve elektronike;
- ▶ Zhvillimi i skemës së qëndrueshme të financimit dhe blerjes së shërbimeve të ofruara nga organizatat joqeveritare për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për fëmijët viktime të abuzimit me narkotikë në mënyrë që këto shërbime të jenë më të qasshme dhe më afër fëmijëve dhe familjeve.



**ZHVILLIMI NË
FËMIJËRINË
E HERSHME**


ZHVILLIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME

Nota: 2.25

- ▶ Përfshirje e ulët e fëmijëve në edukimin parashkollor, kapacitet i vogël absorbues i rrjetit të institucioneve parashkollore
- ▶ Mungesë e shërbimeve për ndërhyrje të hershme në ambient familjar, mungesë e programeve alternative për mbështetjen e prindërve



Kosova vazhdon të mbetet vendi me përfshirjen më të ulët të fëmijëve në edukimin parashkollor krahasuar me vendet në rajon.



VETËM 15%

E FËMIJËVE TË MOSHËS 3-4 VJEÇ NDJEKIN PROGRAME NË FËMIJËRINË E HERSHME

Vetëm 15% e fëmijëve të moshës 3-4 vjeç ndjekin programe të edukimit në fëmijërinë e hershme, të cilët zakonisht janë fëmijë që jetojnë në ekonomitë familjare më të pasura. Shkaku kryesor për një pjesëmarrje kaq të ulët është kapaciteti i vogël absorbues i rrjetit të institucioneve parashkollore me kosto të përballueshme dhe vetëdija e përgjithshme për format tradicionale të edukimit brenda familjes.¹¹⁶



VETËM 54

INSTITUCIONE PARASHKOLLORE NË SEKTORIN PUBLIK

Në nivel të Kosovës gjithsej janë 54 institucione parashkollore/çerdhe në sektorin publik.¹¹⁷ Institucionet parashkollore janë të fokusuar në zona urbane përderisa 10 komuna nuk kanë asnjë institucion parashkollor publik. Zonat rurale janë pothuajse të përjashtuara nga qasja në shërbime për zhvillim në fëmijëri të hershme. Ndërkaq, 172 institucione parashkollore private në Kosovë janë të licencuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Sa i përket institucioneve parashkollore private të cilat operojnë pa licencë nuk dihet numri i saktë.

Numri total i fëmijëve të përfshirë në arsimin parashkollor në vitin 2021/2022 është 32,397, ku 24,431 fëmijë janë të përfshirë në arsimin parashkollor publik, kurse 7,966 fëmijë në arsimin parashkollor privat. 4937 fëmijë janë të përfshirë në institucionet parashkollore publike (0<5 vjeç), ndërsa 19,494 janë të përfshirë në arsimin parafillor publik (5-<6 vjeç). Sa i përket institucioneve edukative-arsimore private

¹¹⁶ Politika Rekomanduese për Zhvillimin në Fëmijëri të Hershme, KOMF, <https://komfkosova.org/politike-rekomanduese-per-zhvillimin-ne-femijerine-e-hershme/>

¹¹⁷ Të dhënat nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, 2022

të licencuara nga MASHTI, aktualisht në arsimin parashkollor (0-5 vjeç) janë të përfshirë 5,374 fëmijë dhe në arsimin parafillor (5-<6 vjeç) janë të përfshirë 2,592 fëmijë.¹¹⁸

Fëmijët që vijnë nga grupet e marginalizuara edhe pse janë të liruar nga pagesa, shumë shpesh nuk përfshihen për shkak të kufizimit të numrit të fëmijëve.¹¹⁹ Nga total 4,937 fëmijë në arsimin parashkollor publik, vetëm 98 fëmijë i përkasin komuniteteve të tjera jo shumicë, ndërsa 4,839 janë Shqiptarë. Nga numri i përgjithshëm i fëmijëve në arsimin parafillor, 95.9 % e fëmijëve janë Shqiptarë, ndërsa 4.1 % e fëmijëve i përkasin grupeve të tjera etnike.¹²⁰

Kujdesi dhe edukimi në fëmijërinë e hershme janë edhe më kritik tek fëmijët me aftësi të kufizuara.¹²¹ Shërbimet për identifikim dhe ndërhyrje të hershme mungojnë. Në vitin 2021/2022, 45 fëmijë me aftësi të kufizuara të moshës (1-6 vjeç) janë përfshirë në qendra burimore/shkolla speciale. 511 fëmijë me aftësi të kufizuara të moshës (1-6 vjeç) në total janë përfshirë në klasat e rregullta.¹²² Megjithatë nga të dhënat zyrtare potencohet se te dhënat e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe saktësia e këtyre të dhënave është komplekse për faktin që akoma nuk janë vlerësuar të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara. Kjo për shkak se në shumicën e komunave janë krijuar vetëm formalisht por nuk funksionojnë komisionet vlerësuese për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Shumica e shërbimeve profesionale për fëmijët me aftësi të kufizuara ofrohen nga sektori joqeveritar, të cilët sfidë kryesore e kanë mos qëndrueshmërinë e shërbimeve.

Nga të dhënat e mësipërme evidentohet se nga shërbimet e fëmijërisë së hershme kryesisht përfitojnë një shtresë e caktuar e fëmijëve e cila ka një situatë më të favorshme financiare dhe sociale.

Një numër i madh i kopshteve private punojnë pa licencë dhe mungon sistemi i monitorimit dhe inspektimit. Institucionet e qëndrimit ditor kanë të përfshirë fëmijë të moshës para fillore, mirëpo inspektimi i bërë në baza periodike bëhet vetëm në kopshte.¹²³ Po ashtu, nëse kopshtet janë të regjistruara si organizata joqeveritare atëherë ato nuk hyjnë nën fushëveprimin e inspektoratit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Duke qenë se vetëm 15%¹²⁴ e fëmijëve të moshës së nivelit parashkollor janë të përfshirë në institucionet parashkollore, pjesa dërrmuese e fëmijëve në vitet e para mbeten në mjediset në shtëpi, kryesisht me nënat e tyre shpesh të papuna si kujdestare parësore dhe pa ndonjë mbështetje në ambientet familjare të fëmijëve, jashtë mjediseve institucionale. Vetëm 1 në 3 fëmijë të moshës (2-4 vjeç) kanë stimulim të hershëm nga secili anëtar i rritur i familjes siç janë rrëfimi i tregimeve, këndim i këngëve, lexim i librave ose lojëra të thjeshta.¹²⁵

Në Kosovë, ka mungesë të programeve alternative për mbështetjen e prindërve, shërbime për ndërhyrje të hershme në ambient familjar, mungesë të qendrave ditore, qendrave mësimore, qendrave në komunitet, grupeve mbështetëse të prindërve, etj. Është i nevojshëm zhvillimi i programeve për mbështetjen e prindërve, familjeve dhe kujdestarëve në ambientet familjare të fëmijëve, jashtë mjediseve institucionale.

Shërbimet për zhvillimin në fëmijërinë e hershme nuk janë të integruara mes sektorëve të arsimit, shëndetësisë dhe atë të mirëqenies sociale. Shërbimet janë të izoluar, të paintegruara dhe të pakoordinuara – familja endet dhe shkon nëpër institucione të ndryshme për të marrë shërbimet. Shërbimet janë kryesisht të natyrës kuruese dhe mungojnë shërbimet parandaluese.¹²⁶

¹¹⁸ Statistikat e Arsimit në Kosovë 2021-2022, <https://masht.rks-gov.net/statistikat-e-arsimit-ne-kosove-2021-2022/>

¹¹⁹ Të dhënat nga organizata Balkan Sunflowers Kosova

¹²⁰ Statistikat e Arsimit në Kosovë 2021-2022, <https://masht.rks-gov.net/statistikat-e-arsimit-ne-kosove-2021-2022/>

¹²¹ Të dhënat nga Down Syndrome Kosova

¹²² Statistikat e Arsimit në Kosovë 2021-2022, <https://masht.rks-gov.net/statistikat-e-arsimit-ne-kosove-2021-2022/>

¹²³ Të dhënat nga organizata Terre Des Hommes

¹²⁴ Anketa e Treguesve të Shumëfishtë MICS 2020, Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe UNICEF, <https://askapi.rks-gov.net/Custom/08eb3166-e575-407a-a383-d959ead4088e.pdf>

¹²⁵ Anketa e Treguesve të Shumëfishtë MICS 2020, Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe UNICEF, <https://askapi.rks-gov.net/Custom/08eb3166-e575-407a-a383-d959ead4088e.pdf>

¹²⁶ Udhëzuesi për Metodologjinë dhe Ndërhyrjen në Fëmijërinë e Hershme, KOMF, https://komfkosova.org/wp-content/uploads/2021/04/Manuali-per-zhvillimin-ne-femijerine-e-hershme_compressed.pdf

Një nismë drejt ndërhyrjes në fëmijëri të hershme përmes shërbimeve në familje është edhe modeli i vizitave sistematike në shtëpi, i cili realizohet nga profesionistët shëndetësor të kujdesit parësor në kuadër të Qendrave të Mjekësive Familjare. Një model i tillë do të ishte i përshtatshëm edhe për shërbimet në fëmijëri të hershme për të ofruar mbështetje për prindërit dhe kujdestarët.

Hap pozitiv është miratimi i Ligjit për Edukimin në Fëmijëri të Hershme. Ndër risitë që sjell ky ligj është vendosja e bazës ligjore për koordinimin ndër sektorial dhe integrimin e shërbimeve në mes të sektorëve të arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale në fëmijëri të hershme.

Përderisa, procesi i hartimit të Kurrikulës për Edukimin në Fëmijëri të Hershme edhe pse i nisur vite më parë, nuk ka arritur të miratohet.

Rekomandime:

- ▶ Finalizimi dhe aprovimi i Kurrikulës për Edukimin në Fëmijëri të Hershme;
- ▶ Hartimi dhe aprovimi i udhëzimeve administrative që burojnë nga Ligji për Edukimin në Fëmijëri të Hershme;
- ▶ Rritja e numrit të institucioneve parashkollore dhe rritja e përfshirjes së fëmijëve në nivelin parashkollor;
- ▶ Përfshirja më e madhe e fëmijëve të cenueshëm sikurse fëmijët më aftësi të kufizuara, fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijët që jetojnë në varfëri, fëmijët e komuniteteve, etj, në kuadër të institucioneve parashkollore;
- ▶ Zhvillimi i programeve alternative për zhvillimin në fëmijëri të hershme sikurse programet për mbështetjen e prindërve, qendrat në komunitet, qendrat ditore, kujdesi për fëmijët në familje, ndërhyrja në fëmijëri të hershme, grupet e prindërve, vizitat sistematike në shtëpi, ekipet mobile për fëmijëri të hershme, platformat online për fëmijëri të hershme;
- ▶ Rritja e shumës së subvencioneve për Qendrat Mësimore që ofrojnë mbështetje për fëmijët në nivelin parashkollor nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- ▶ Realizimi i vizitave sistematike në shtëpi bashkë me profesionistët shëndetësor dhe social për të bërë identifikim të hershëm, menaxhim të rasteve dhe ofrim të mbështetjes për prindërit dhe kujdestarët për zhvillimin në fëmijëri të hershme;
- ▶ Zbatimi i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve në institucionet parashkollore si mjet kyç për të siguruar ambient të sigurtë dhe mbrojtës për fëmijët si dhe ngritja e kapaciteteve të profesionistëve për zbatimin e saj;
- ▶ Integrimi i shërbimeve për zhvillimin në fëmijëri të hershme mes sektorëve të arsimit, shëndetësisë dhe atë të mirëqenies sociale sipas Ligjit të ri për Edukim në Fëmijëri të Hershme;
- ▶ Përmirësimi i vlerësimit dhe inspektimit të cilësisë së shërbimeve parashkollore;
- ▶ Themelimi apo funksionalizimi i komisioneve vlerësuese për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- ▶ Krijimi i bazës ligjore dhe standardeve për qëndrime ditore të fëmijëve të moshës së arsimit fillor të cilat operojnë ose ndaras ose në kuadër të kopshteve private;
- ▶ Ndërlidhja me Departamentin për organizata joqeveritare në kuadër të Ministrisë respektive (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal apo Ministria e Punëve të Brendshme) në rastet kur kopshtet private janë të regjistruara si organizata joqeveritare.



READY
STEADY
GO!

ARSIMI

ARSIMI

Nota: 2.5

- ▶ Cilësi e ulët e arsimit në Kosovë
- ▶ Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla nuk është kuptimplotë dhe e bazuar në nevojat individuale të fëmijëve
- ▶ Mungesë e stafit profesional dhe mbështetës sikurse psikologë, pedagogë dhe asistentë për fëmijë me aftësi të kufizuara në shkolla



Vetëm 609

shkolla kanë qasje për fëmijët me aftësi të kufizuara¹²⁷



Vetëm rreth **200** psikologë dhe pedagogë për **1047** shkolla¹²⁸



“PISA”

KA RADHITUR KOSOVËN NË VENDIN E 68-TË NË MESIN E 72 SHTETEVE

duke rezultuar me nivel të ulët të cilësisë në arsim. Ka shumë faktorë të cilët ndikojnë që Kosova të ketë cilësi të ulët në arsim, sikurse, cilësia e mësimdhënësve, shkolla të mbingarkuara, numri tejet i madh i nxënësve në klasa e sidomos në qytete, mungesa e infrastrukturës në shkolla, menaxhimi jo i mirë, politizimi i kuadrove arsimorë në shkolla, mos funksionimi i bashkëpunimit në mes të prindërve, mësimdhënësve dhe nxënësve, llogaridhënia e ulët, etj.¹³¹

Gjithsej në arsimin parauniversitar janë 327,676 nxënës/e (prej tyre 169,143 djem dhe 158,533 vajza.) Në sistemin arsimor fillor dhe të mesëm të ulët janë të përfshirë 224,429 nxënës/e ndërsa arsimin e mesëm të lartë e ndjekin 70.850 nxënës/e.¹²⁹

Sipas të dhënave të MASHTI për vitin 2021-2022, numri i personelit arsimor është 27,915, prej tyre 23,033 janë mësimdhënës/e, 1,606 janë personel administrativ dhe 3,276 janë personel ndihmës. Numri i institucioneve edukative-arsimore publike në Kosovë është gjithsej 1,047 institucione arsimore.¹³⁰

Arsimi para universitar ballafaqohet me sfida dhe probleme të shumta, të cilat reflektojnë në cilësinë jo të mirë të arsimit në Kosovë. Programi për vlerësim ndërkombëtar të nxënësve

¹²⁷ Të dhënat nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, 2022

¹²⁸ Të dhënat nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, 2022

¹²⁹ Statistikat e arsimit në Kosovë 2021-2022, <https://masht.rks-gov.net/statistikat-e-arsimit-ne-kosove-2021-2022/>

¹³⁰ Statistikat e arsimit në Kosovë 2021-2022, <https://masht.rks-gov.net/statistikat-e-arsimit-ne-kosove-2021-2022/>

¹³¹ Të dhënat nga organizatat anëtare të KOMF

Më qëllim të krijimit të një sistemi për parandalim, reagim dhe mbrojtje të fëmijëve, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit miratoi Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Edhe pse po bëhen përpjekje të vazhdueshme në drejtim të realizimit të konceptit të arsimit gjithëpërfshirës, ky proces është i shoqëruar me vështirësi të shumta duke qenë se Kosova ende është në proces të krijimit të kulturës e praktikës, e cila vlerësohet të jetë rrugë e gjatë dhe kërkon burime njerëzore dhe fonde të mjaftueshme.¹³² Në Kosovë janë bërë hapa në avancimin e politikave dhe legjisllacionit duke tentuar përfshirjen e konceptit të gjithëpërfshirjes si pjesë integrale në të gjitha politikat. Megjithatë sa i përket zbatimit të politikave dhe zhvillimit të mekanizmave që sigurojnë gjithëpërfshirjen, ende ka shumë punë për të bërë. Ndër sfidat kryesore për realizimin e arsimit gjithëpërfshirës konsiderohen: trajnimi joadekuat i mësimitdhënësve, mungesa e metodave të mësimitdhënies gjithëpërfshirëse, mungesa e pajisjeve mbështetëse teknologjike, normat dhe qëndrimet shoqërore, kurrikula, faktorët socio-ekonomik dhe mungesa e burimeve njerëzore dhe fondeve.¹³³

Situatë më sfiduese mbetet përfshirja e fëmijëve më të cenueshëm në të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë, sikurse fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët nga komunitetet jo shumicë, të cilët nuk e marrin mbështetjen e duhur për të arritur potencialin e tyre të plotë.¹³⁴

Duke qenë se Kosova nuk ka statistikë zyrtare për numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, është e pamundur të përcaktohet shkalla e përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucione arsimore. Mungesa e të dhënave është pengesa kryesore në adresimin e nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Mbledhja e të dhënave bëhet edhe më e vështirë sepse nuk ka harmonizim të mekanizmave dhe sistemeve mes ministrive. Informatat që mblidhen në nivel shkollë dhe që mund të përdoret në të ardhmen për qëllime financimi, mund të mos jenë të besueshme pasi që i mungon dokumentacioni përkatës mbështetës.¹³⁵ Nga gjithsej 1094 institucione shkollë, 609 shkolla kanë qasje për fëmijët me aftësi të kufizuara.¹³⁶ Edhe pse me akte ligjore është përcaktuar që çdo komunë të ketë ekipet komunale për vlerësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, shpesh këta fëmijë identifikohen vetëm kur arrijnë moshën shkollë dhe përipiqen të regjistrohen në shkollë, e që ndërhyrja është tashmë shumë vonë për të pasur një ndikim

të qëndrueshëm në zhvillimin e tyre. Shumica e komunave kanë themeluar ekipet komunale për vlerësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, por jo të gjitha ekipet janë funksionale. Për më tepër, ka komuna të vogla sikurse Komuna e Klinës dhe Dragashit që nuk e kanë të themeluar ekipin vlerësues për shkak që kanë vështirësi për kuadrin e nevojshëm ose vështirësi financimi sipas udhëzimit administrativ.¹³⁷ Si pasojë, shpesh për fëmijët me aftësi të kufizuara nuk realizohet vlerësimi dhe nuk bëhen planet individuale që i përgjigjen dëmtimit të çdo fëmije dhe pengesave mjedisore.

Një sfidë tjetër me të cilën përballen fëmijët, prindërit por edhe shkollat është numri i ulët i mësimitdhënësve mbështetës dhe asistentëve të cilët punojnë me fëmijët me aftësi të kufizuara. Aktualisht, në vitin shkollor 2021/2022, 291 nxënës me aftësi të kufizuara vijnë në mësimin në qendra burimore/shkolla speciale.



VETËM 3,965 FËMIJË

ME AFTËSI TË KUFIZUARA JANË TË PËRFSHIRË NË
KLASAT E RREGULLTA

Gjithashtu, arsimit gjithëpërfshirës është i mundur kur prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara kanë informacionin dhe mbështetjen e duhur. Mbështetja për prindërit dhe shtrirja e shërbimeve drejt tyre është e ulët, e fragmentuar dhe kryesisht e kufizuar në iniciativat e shoqërisë civile. Pa shërbime në nivel lokal, shumë familje ndihen të paaftha në mbështetjen e zhvillimit psikosocial të fëmijëve të tyre, rehabilitimin në shtëpi dhe përfshirjen e tyre në shkollë dhe në komunitet.

Shkollat kanë mungesë të stafit profesional dhe mbështetës sikurse psikologë, pedagogë dhe asistentë për fëmijë me aftësi të kufizuara. Aktualisht në shkolla në nivel vendi janë rreth 200 psikologë dhe pedagogë.¹³⁸ Marrë parasysh numrin e institucioneve arsimore prej 1,047 konstatohet se as çereku i shkollave nuk kanë psikologë/e të punësuar në shkollë. Në

¹³² Të dhënat nga Ministria e Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, 2022

¹³³ Të dhënat nga Ministria e Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, 2022

¹³⁴ Të dhënat nga organizatat anëtare të KOMF

¹³⁵ Hunt P.F.; Belegu-Caka V.: Situation analysis: children with disabilities in Kosovo, Prishtina: Unicef, 2018. <https://www.unicef.org/kosovoprogramme/media/216/file/KOS-SITAN-ENG.pdf>

¹³⁶ Të dhënat nga Ministria e Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, 2022

¹³⁷ Të dhënat nga Ministria e Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, 2022

¹³⁸ Të dhënat nga Ministria e Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, 2022

të shumtën e rasteve, një psikolog mbulon katër shkolla. Përderisa ka komuna që nuk kanë fare psikologë.

Veprim për tu vlerësuar gjatë vitit 2022, ishte punësimi i 100 asistentëve për fëmijë me aftësi të kufizuara, të cilët do të mbështesin një numër të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Përtej kësaj, duhet të vazhdohet më tutje me punësimin dhe rritjen e asistentëve për fëmijët me aftësi të kufizuara për të mbuluar nevojat e të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara. Por, një shqetësim tjetër është ngritur nga organizatat anëtare të KOMF lidhur me asistentët mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara në institucionet e arsimit, të cilët nuk janë duke e zhvilluar angazhimin e tyre përmes ofrimit të mbështetjes profesionale ashtu sikurse është paraparë në legjislacion.

Sipas të dhënave zyrtare braktisja e shkollimit është e një shkalle të ulët, por si fenomen konsiderohet më i pranishëm dhe shqetësues tek komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.¹³⁹ Gjendja vazhdon të mbetet e pakënaqshme për sa i përket arsimit të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Ndër arsyt kryesore për mos përfshirje në arsim janë: mosgatishmëria për t'u regjistruar në shkollë, braktisja e shkollës, përfshirja e fëmijëve në punë të rënda, mungesa e motivimit për arsimim dhe shkollim, si dhe mungesa e vetëdijesimit të prindërve dhe familjes për rëndësinë e arsimit të fëmijëve të tyre.¹⁴⁰

Në përgjithësi vlerësohet se një nga sfidat kryesore të parandalimit të braktisjes së shkollës është mungesa e raportimit të bërë nga shkollat SPH (Sistem të Paralajmërimit të Hershëm). Po ashtu, ekipet për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar në nivel shkollë nuk funksionojnë në mënyrën e duhur. Në disa komuna madje nuk janë themeluar fare, ndërsa ka raste që janë të themeluara vetëm formalisht, gjë që ndikon negativisht dhe pamundëson ndërmarrjen e masave parandaluese sa i përket braktisjes së shkollimit, sidomos për fëmijët e komuniteteve. Në të gjitha rastet këto ekupe nuk merren me parandalimin dhe reagimin ndaj rasteve të mosregjistrimit.

Ndërkohë, qendrat mësimore ekzistuese të organizuara nga organizatat joqeveritare për mësim shtesë shihen si institucione shpresëdhënëse për mbështetjen në arsim të fëmijëve nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian

dhe parandalimin e braktisjes së shkollës. Mirëpo, këto qendra janë duke u përballur me një sërë sfidash për shkak të mungesës së financimit dhe neglizhencës së përgjegjësive institucionale, duke rrezikuar edhe mbylljen e tyre. Aktualisht, Qeveria e Kosovës ndan vetëm 200,000 Euro për një vit shkollor për subvencionimin e qendrave mësimore përmes thirrjes publike për financimin e projekteve të organizatave joqeveritare që drejtojnë qendra mësimore që mbështesin nxënësit Rom, Ashkali dhe Egjiptian, si dhe nxënës të tjerë, që kontribuojnë në arritjen arsimore. Kjo shumë konsiderohet shumë e ulët për të mbuluar nevojat për funksionimin e qendrave mësimore duke patur parasysh se janë mbi 48 qendra mësimore të licencuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Çështje tjetër është paqartësia në zbatimin e udhëzimit administrativ nr. 19/2018 për themelimin dhe funksionimin e qendrave mësimore lidhur me licencimin dhe ri-licencimin, institucionalizimin dhe financimin nga niveli komunal. Kjo është një pengesë e madhe në sigurimin e qëndrueshmërisë së këtyre qendrave mësimore të cilat për momentin menaxhohen nga organizatat joqeveritare.

Sa i përket përfshirjes në sistem arsimor të fëmijëve që vijnë nga familjet me status të ulët socio-ekonomik, për vitin shkollor 2021/2022, 14,184 fëmijë, familjet e të cilëve janë me asistencë sociale, janë të përfshirë në institucionet e arsimit, 4,278 fëmijë janë me një prind dhe 132 fëmijë pa asnjërin prind.¹⁴¹ Mirëpo, nuk ka të dhëna nëse janë ndërmarrë masa nga institucionet për adresimin e nevojave të fëmijëve në arsim që vijnë nga familjet me status të ulët socio – ekonomik.

Shkollat në Kosovë nuk e plotësojnë në plotni konceptin e shkollave mike për fëmijë, kjo për shkak të mjedisit jo të sigurt dhe jo miqësor, infrastrukturës së papërshtatshme, qasjes së mësimdhënësve si dhe mungesës së bashkëpunimit të shëndetshëm në mes të nxënësve, mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit.

Sipas hulumtimit të zhvilluar nga Këshilli i Nxënësve në Kosovë, 27.9% e profesorëve i godasin fizikisht nxënësit. 34.4% e nxënësve kanë raportuar që në shkolla ka mësimdhënës që ngacmojnë seksualisht. Nxënësit bullizohen nga nxënësit në 40.2% të rasteve. Ndërsa, sipas të njëjtit hulumtim, 41.2% e nxënësve deklaruan se në shkollat e tyre nuk ka bibliotekë, 49% e nxënësve deklaruan se në shkollat e tyre nuk ka roje sigurimi, 61.9% e nxënësve deklaruan që ndjehen të rrezikuar nga qentë endacak rrugës për në shkollë.¹⁴²

¹³⁹ Strategjia e Arsimit 2022-2026, <https://masht.rks-gov.net/strategjia-e-arsimit2022-2026/>

¹⁴⁰ Të dhënat nga organizatat anëtare të KOMF

¹⁴¹ Statistikat e arsimit 2021-2022, <https://masht.rks-gov.net/statistikat-e-arsimit-ne-kosove-2021-2022/>

¹⁴² Perceptimi i nxënësve rreth përmbajtjes, procesit dhe mjedisit mësimor, Këshilli i Nxënësve 2022

Në Kosovë koncepti i pjesëmarrjes së fëmijës është relativisht i ri. Ky koncept është përfshirë në kuadër të legjislationit sikurse në kuadër të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Fëmijëve, rregulloreve dhe akteve të tjera nënligjore në nivel qendror dhe komunal. Edhe pse sipas legjislationit në fuqi, roli i Këshillit të Nxënësve është të punojë në përmirësimin e mjedisit mësimor, dhe interesave që kanë të bëjnë me shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve si dhe përfaqësimin në Këshillin Drejtues,

fatkeqësisht praktikat tregojnë se në shumicën e rasteve këshillat e nxënësve, por edhe organizimet e tjera të fëmijëve janë të themeluara formalisht dhe përmes procedurave që nuk janë aspak demokratike, por përkundrazi shpeshherë të imponuara nga mësimmshënësit dhe menaxhmenti i shkollës. Këshillat e Nxënësve në vend që denjësisht të përfaqësojnë interesat e nxënësve të shkollës, më tepër janë në funksion të kontrollit të nxënësve nga mësimmshënësit dhe menaxhmenti i shkollës.¹⁴³

Rekomandime:

- ▶ Zbatimi i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve në institucionet që punojnë me fëmijë, si mjet kyç për të siguruar ambient të sigurtë dhe mbrojtës për fëmijët;
- ▶ Krijimi i shkollave mike për fëmijë për të ofruar mjedise të shëndetshme, humane, miqësore e të sigurta, mbështetje nga mësimmshënësit si dhe mbi të gjitha përfshirje dhe pjesëmarrje aktive të vetë nxënësve;
- ▶ Themelimi apo funksionalizimi i komisioneve vlerësuese për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- ▶ Largimi i barrierave fizike për të siguruar qasjen për fëmijët me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore;
- ▶ Zbatimi i rolit të asistentit mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara ashtu sikurse është i paraparë në legjislation dhe punësimi i asistentëve shtesë bazuar në nevoja;
- ▶ Themelimi apo funksionalizimi (sipas specifikave të komunës) të ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos regjistrimit në arsimin e obliguar;
- ▶ Punësimi i psikologëve dhe pedagogëve në shkolla;
- ▶ Funksionalizimi i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm;
- ▶ Rritja e shumës së financimit për Qendrat Mësimore për të siguruar qëndrueshmërinë e shërbimeve të tyre;
- ▶ Investimi në ngritjen e cilësisë së arsimit përmes ngritjes së kapaciteteve të mësimmshënësve, rishikimit të teksteve shkollore, digjitalizimit të arsimit dhe përshtatjes së nevojave të tregut të punës.

¹⁴³ Politikë e shkurtër, Trekëndëshi pedagogjik, ETEA 2022, https://issuu.com/etea.ks/docs/trekendeshi_pedagogjik_politike_e_shkruter



**DREJTËSIA
PËR TË MITUR**

DREJTËSIA PËR TË MITUR

Nota: 2

- ▶ Mungesë e shërbimeve për parandalimin dhe mbrojtjen e të miturve në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale
- ▶ Rënie e theksuar e zbatimit të masave të diversitetit në sistemin e drejtësisë për të mitur
- ▶ Mungesë e profesionistëve për rehabilitimin dhe re-integrimin e të miturve në sistemin edukativ dhe korrektues



FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN NËN MOSHËN E PËRGJEGJËSISË PENALE

Gjatë vitit 2022, Qendrat për Punë Sociale në kuadër të mbrojtjes së kësaj kategorie, kanë menaxhuar



579 RASTE

**TË FËMIJËVE TË MITUR NË KONFLIKT ME LIGJIN,
NËN MOSHËN E PËRGJEGJËSISË PENALE¹⁴⁴**

Shërbimet sociale për fëmijët në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale janë ofruar në bashkëpunim me partnerët e tjerë si: Policia, Shërbimi Sprovues, familja, shkollat, organizatat joqeveritare, dhe akterët e tjerë brenda sistemit të mbrojtjes së fëmijës.

Në kuadër të zbatimit të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 01/2021 për Mbrojtjen dhe Trajtimin e Fëmijëve Kryerës të Veprave Penale nën Moshën e Përgjegjësisë Penale¹⁴⁵, janë krijuar: Ekipi për monitorimin dhe zbatimin e Udhëzimit Administrativ për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve kryerës të

veprave penale nën moshën e përgjegjësisë penale\02-1708.¹⁴⁶, Rregullorja e punës së ekipit për monitorimin e zbatimit të udhëzimit administrativ qrk 01.2021 për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve kryerës të veprave penale nën moshën e përgjegjësisë penale dhe standardet për rekomandimet e ekipit, përbajtjen e raportit të ekipit si dhe cilësinë e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të udhëzimit administrativ.

Me këtë Udhëzim Administrativ, për fëmijën kryerës të veprave penale nën moshën e përgjegjësisë penale, përcaktohet: Mbrojtja; programi i mbrojtjes; ndërmjetësimi ndërmjet bashkëmoshatarëve; ndihma juridike dhe trajtimi.

Megjithatë implementimi i Udhëzimit Administrativ dhe funksionalizimi i mekanizmave zbatues të tij, vazhdon të mbetet sfidë. Kjo ndodh për shkak të kapaciteteve tejet të kufizuara në kuadër të Qendrave për Punë Sociale për të ofruar shërbimet e nevojshme në përputhje me nevojat. Vlen të përmendet se në këtë drejtim, ka mungesë të theksuar të shërbimeve edhe nga ofruesit e tjerë, siç është sektori joqeveritar. Po ashtu mangësi të sistemit përbën edhe mungesa e punës me familjen ku sërish Qendrat për Punë Sociale kanë mungesë të burimeve njerëzore të nevojshme për të realizuar punën me familjen, e cila në këto raste duhet zhvilluar paralelisht me punën që bëhet me fëmijën.

Përveç sfidës në ofrimin e shërbimeve sociale, problematikë paraqesin edhe rastet e të miturve të cilët duhet të largohen nga familjet e tyre për shkak të mos kujdesit të duhur prindëror. Për raste të tilla nuk ka asnjë formë të strehimit familjar të specializuar, as shërbime të qëndrimit ditor e as rezidencial, të cilët do të mund të ofronin shërbime të specializuara e profesionale për rehabilitimin dhe re-integrimin e këtyre fëmijëve.

¹⁴⁴Të dhënat nga Departamenti për Politika Sociale dhe të Familjes, Ministria e Drejtësisë, 2022

¹⁴⁵ UA QRK-Nr-01-2021; <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=36551>

¹⁴⁶ Vendim për themelimin e Ekipit për monitorimin e zbatimit të UA QRK-Nr-01-2021; <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=50068>

Themelimi i shërbimeve të specializuara për fëmijët në konflikt me ligjin nën moshën e përgjegjësisë penale pritet të realizohet me miratimin e Ligjit të ri për Shërbime Sociale dhe Familjare.

FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN ME PËRGJEGJËSI PENALE, TË DREJTAT, PROGRAMET DHE SHËRBIMET PËR TA



SHËRBIMI SPROVUES I KOSOVËS KA PËRPUNUAR GJITHSEJ 700 RASTE ME TË MITUR

Në vitin 2022, Shërbimi Sprovues i Kosovës ka përpunuar gjithsej 700 raste me të mitur, ku veprat më dominante kanë përfshirë lëndime, sulme, vjedhje e të tjera. Nga numri total i rasteve të pranuar, janë ekzekutuar 387 masa diversiteti, 245 masa edukative si dhe 31 raste me urdhër për punë në dobi të përgjithshme.¹⁴⁷

Në kuadër të Shërbimit Sprovues zbatohet intervista motivuese dhe programet sikurse Menaxhimi i Zemërimit dhe Biseda për Ndryshim. Tutje, për ofrimin e ndihmës profesionale për të miturit, SHSK ka marrëveshje me shumë institucione siç janë Qendrat e Shëndetit Mendor, Qendrat për Punë Sociale, Qendrat e Aftësisë Profesionale, Organizatat joqeveritare si dhe me institucionet lokale ku zbatohen masat alternative. Megjithatë, zbatimi i legjislacionit ekzistues, zhvillimi dhe zbatimi i programeve për parandalim, mbrojtje dhe reintegrim të fëmijëve të rrezikuar, ende mbetet sfidë, përkundër avancimit të kornizës ligjore dhe politikave e reformave të vazhdueshme në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve dhe drejtësisë për fëmijët në Kosovë.

Edhe pse Kodi i ri i Drejtësisë për të Mitur ka dyfishuar masat e diversitetit nga 8 në 16¹⁴⁸, e të cilat luajnë një rol vendimtar në parandalimin e fillimit të procedurave gjyqësore kundër të miturve dhe nxitjen e rehabilitimit dhe reintegrimin të tyre në shoqëri, zbatimi efektiv i masave të diversitetit ballafaqohet me pengesa dhe sfida të ndryshme. Për më tepër, në vitet e fundit vihet re një rënie e theksuar e zbatimit të këtyre masave në sistemin e drejtësisë për të mitur, duke ngritur shqetësime për pasojat e mundshme në jetën e të miturve dhe gjastat e tyre për rehabilitim të suksesshëm.



2,341

KALLËZIME PENALE PËR TË MITUR

Gjatë vitit 2022, nga 2,341 kallëzime penale për të mitur me 3,639 persona, prokurorët e Drejtësisë për të Mitur të Prokurorive Themelore kanë zgjidhur 1,661 kallëzime penale me 2,477 persona të mitur. Konkretisht, për 389 ose 15.70% të personave të mitur, nuk ka filluar procedura përgatitore (parimi i oportunitetit). Për 29 ose 1.17% të personave të mitur është propozuar procedura e ndërmjetësimit. Për 182 ose 7.34% të personave të mitur është pushuar procedura përgatitore. Për 434 ose 17.54% të personave të mitur është hedhur kallëzimi penal. Për 207 ose 8.35%, të personave të mitur është propozuar të shqiptohet masa e diversitetit¹⁴⁹. Nga këto të dhëna shihet se kemi një ulje drastike të masave të diversitetit të shqiptuara nga ana e prokurorisë, dhe më shqetësues është fakti që masat e reja të diversitetit nuk janë duke gjetur zbatim.

Një prej arsyeve kryesore që pengon zbatimin efektiv të masave të diversitetit, është mungesa e trajnimeve të nevojshme për profesionistët e drejtësisë për të mitur, si zyrtarë policor, prokurorë, gjyqtarë, avokatë dhe punëtorë social që kanë kontakt me fëmijët. Ata nuk marrin trajnime të rregullta për punën që zhvillojnë me fëmijë. Madje ata nuk kanë marrë trajnime as për masat e reja të diversitetit të parashikuara për herë të parë në Kodin e Drejtësisë për të Mitur, gjë që do të mundësonte njohjen më të mirë të këtyre masave, qëllimeve të tyre e për pasojë edhe aplikimin e tyre në rastet e duhura. Për më tepër, nuk ekziston asnjë monitorim i realizuar në lidhje me zbatimin e masave nga profesionistët e drejtësisë për fëmijë, i cili do të paraqiste të dhëna të sakta, do të identifikonte zbrastëtitë dhe do të ofronte mundësitë për përmirësim.

Programet aktuale kurrikulare për drejtësi për të mitur dhe mbrojtje të fëmijëve, të Akademisë së Kosovës për Drejtësi, kanë nevojë për rishikim të menjëhershëm. Ato duhet të hartohen bazuar në standardet ndërkombëtare dhe Europiane për të drejtat e fëmijëve dhe drejtësinë për të mitur, duke përfshirë konceptet e mbrojtjes së fëmijëve, teknikat e intervistimit dhe komunikimin miqësor me fëmijët gjatë procedurave gjyqësore.

¹⁴⁷ Të dhënat nga Shërbimi Sprovues i Kosovës, 2022

¹⁴⁸ Neni 20 i Kodit të Drejtësisë për të Mitur, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18019>

¹⁴⁹ Raport Vjetor i Punës së Prokurorit të Shtetit 2022, <https://www.prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/RAPORTI%20VJETOR%20I%20PROKURORIT%20TE%20SHTETIT%202022.pdf>

Ndërkohë, Shërbimi Korrektues i Kosovës, gjatë vitit 2022 ka pranuar 126 raste të fëmijëve në konflikt me ligjin, ku si vepra më dominante ishin 24 lëndime të lehta dhe të rënda trupore, 22 vjedhje dhe vjedhje e rëndë, 19 grabitje, 11 vrasje në tentativë dhe 10 dhunime, si dhe vepra të tjera. Nga 126 veprat penale të kryera nga fëmijët me përgjegjësi penale, në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan, janë ekzekutuar 25 masa edukuese korrektuese, 2 të dënuar me burgim për të mitur si dhe 99 të paraburgosur.¹⁵⁰

Vendosja dhe trajtimi i rasteve të të miturve të pranuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, bëhet në Qendrën Edukuese Korrektuese dhe Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan. Sipas Kodit së Drejtësisë për të Mitur, institucioni korrektues për të mitur është i llojit gjysmë të hapur dhe të hapur. Mirëpo Qendra Korrektuese për të Mitur në Lipjan dhe Qendra Edukative Korrektuese administrohen nga i njëjti menaxhment dhe vendosja e të miturve me masë edukative korrektuese në Qendrën Edukative Korrektuese, bëhet vetëm pasi të miturit fillimisht vendosen në Qendrën Korrektuese dhe pasi t'i plotësojnë disa kriteret mund të kalojnë në Qendrën Edukative Korrektuese.¹⁵¹

Kjo nënkupton se në Qendrën Edukative Korrektuese të tipit të hapur nuk bëhen pranime të drejtpërdrejta sipas vendimit të Gjykatës, por vetëm transfere nga Qendra Korrektuese. Gjatë vitit 2022, në total janë bërë 25 transfere. Kësisoj, të miturit me masë edukative korrektuese mbahen në institucion të tipit të mbyllur, gjë që përbën shkelje të dispozitave të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, rrjedhimisht shkelje të rëndë të të drejtave themelore të fëmijëve. Regjimi dhe rutina mes të miturve me masë edukative korrektuese dhe atyre të dënuar nuk dallon, duke qëndruar në mospajtim me vendimin e gjykatës.

Të miturit në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan ndjekin dy programe rehabilitimi, të cilat janë të pamjaftueshme për të përmbushur funksionet që një qendër korrektuese duhet të ketë dhe programet që ajo duhet të aplikojë me të mitur, sidomos ata nën masa edukative korrektuese. Një mangësi tjetër e evidentuar në sferën e rehabilitimit dhe reintegrimit të këtyre të miturve, është mungesa e punës me familjen.

Një shqetësim tjetër i vazhdueshëm, është fakti që në mungesë të një qendre korrektuese për të miturat femra, ato vendosen në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan me të paraburgosurat/dënuarat e rritura. Në këtë qendër korrektuese nuk ka ambient të veçantë për të miturat e dënuara, të paraburgosura si dhe ato me masa edukative korrektuese, pra vendosja e tyre bëhet në pavijone me të dënuarat dhe të paraburgosurat e moshës madhore.

¹⁵⁰ Të dhënat nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, 2022

¹⁵¹ Të dhënat nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, 2022

¹⁵² Neni 85 paragrafi 4 Kodi i Drejtësisë për të Mitur (Kodi Nr.06/L-006, viti 2018)

Mungesa e stafit profesional, paraqet sfida në menaxhimin e institucioneve korrektuese për Shërbimin Korrektues të Kosovës. Në total numri i stafit të Qendrës Korrektuese ishte 101, prej të cilëve 82 ishin staf korrektues, një punëtor social dhe një psikolog, 12 staf civil dhe pesë staf mbështetës. Ndërsa numri i stafit profesional dhe numri i stafit korrektues në Qendrën Edukative Korrektuese në total ishte 27, prej tyre 24 staf korrektues, një zyrtar për arsimim, një instruktor i IT dhe një mirëmbajtës.



**VETËM NJË PUNËTOR SOCIAL
DHE NJË PSIKOLOG
NË QENDRËN KORREKTUESE
PËR TË MITUR**

Mungesa e edukatorëve vazhdon të mbetet shqetësuese, edhe pse Kodi i Drejtësisë për të Mitur taksativisht përcakton që për çdo 10 të mitur duhet të jetë 1 edukator¹⁵², kjo pozitë nuk është plotësuar asnjëherë deri më tani! Jashtëzakonisht shqetësues është fakti se prej kohësh, në Qendrën Edukative Korrektuese dhe Qendrën Korrektuese është vetëm 1 punëtor social, ndërkohë që në vitin 2022 Shërbimi Korrektues i Kosovës ka pranuar 126 raste të të miturve në konflikt me ligjin. Dhe ky numër na tregon për gjendjen dhe mundësinë reale që 1 punëtor social të punojë dhe të ofrojë shërbime cilësore për gjithë këta të mitur.

Konstatohet numër i madh i zyrtarëve korrektues dhe numër i vogël i stafit profesional. Masat edukative synojnë rehabilitimin e kryerësit të mitur, duke ofruar mbrojtje, ndihmë dhe mbikëqyrje, duke siguruar edukim dhe aftësim profesional, duke zhvilluar përgjegjësinë e tij personale dhe duke ndaluar sjelljen recidiviste, dhe stafi profesional është kuadri përgjegjës për ofrimin e shërbimeve dhe realizimin e programeve për rehabilitim dhe reintegrim të të miturve. Prandaj, për të arritur qëllimin për të cilin jepen këto masa edukative, rekomandohet rritja e numrit të stafit profesional, me fokus punësimin e psikologëve dhe punëtorëve social. Organizimi aktual ka synim primar sigurinë, pengimin e ikjes së të miturve duke lënë neglizhuar punën në rehabilitim, edukim dhe reintegrim të të miturve, që përbën edhe qëllimin e dhënies së masave.

Qendra Korrektuese për të Mitur në Lipjan duhet të ketë burime të mjaftueshme njerëzore për të zbatuar programet individuale, programet rehabilituese dhe reintegruese, programet edukative si dhe format e tjera të ndihmës të cilat janë adekuate në përputhje me nevojat individuale të të miturve me masa edukative dhe atyre të dënuar.

Ndikim të rëndësishëm në trajtimin e të miturve paraqet zhvillimi i planeve individuale. Programet individuale do të duhej të hartoheshin dhe zbatoheshin nga ekipi multidisiplinar i cili punon me të miturit. Kjo gjë që do të ndikonte në përgatitjen e tyre për risocializim dhe gjithashtu në rehabilitimin e tyre.

Ndërkaq, Qendra Edukuese Korrektuese për të miturit është institucion i veçantë për ekzekutimin e Masës Edukative, e cila funksionon si qendër e tipit të hapur, nën menaxhimin e

Qendrës Korrektuese në Lipjan. Megjithatë ky institucion nuk ka pasur asnjëherë të mitura femra të vendosura në të. Edhe pse ekziston një pavijon i veçantë për vendosjen e të miturave, nëse ato do të vendoseshin, menaxhimi i tyre do të ishte mjaft i vështirë për shkak të strukturës së objektit dhe problemi kryesor do të ishte mbajtja larg nga të miturit meshkuj.¹⁵³

Edhe pse neni 119 i Kodit të Drejtësisë për të Mitur përcakton se nëse nuk ka orë mësimore për lëndë të caktuara ose nuk ka nivel arsimor në institucionin edukativ korrektues, i mituri lejohet të vijojë mësimin jashtë institucionit edukativ korrektues, shkollimi për të miturit është i organizuar në Qendrën Korrektuese për të Mitur ku mësojnë edhe të miturit nga Qendra Edukuese Korrektuese. Sistemi arsimor ka sfida si në organizim të procesit mësimor, ashtu edhe në cilësi të mësimdhënies e deri te mos-mbajtja e mësimin për të gjitha lëndët që janë në plan-program, duke rezultuar në nivel të dobët arsimor.

Rekomandime:

- ▶ Rishikimi i programeve aktuale kurrikulare për drejtësi për të mitur dhe mbrojtje të fëmijëve të Akademisë së Kosovës për Drejtësi, me qëllim vlerësimin e nevojave për përmirësim/ndryshim të programeve aktuale;
- ▶ Zhvillimi i programit të ri kurrikular të Akademisë së Drejtësisë me standardet ndërkombëtare dhe ato të Bashkimit Europian për të drejtat e fëmijëve dhe drejtësinë për të mitur, teknikat e intervistimit dhe komunikimin miqësor me fëmijët gjatë procedurave gjyqësore;
- ▶ Organizimi i trajnimeve sistematike për ngritje të kapaciteteve të profesionistëve të sistemit të drejtësisë për punën me fëmijë. Trajnime lidhur me masat e reja të diversitetit të parapara sipas Kodit për Drejtësi për të Mitur;
- ▶ Zhvillimi i programeve individuale të përshtatura me gjendjen, zhvillimin psikik dhe atë fizik të secilit të mitur, në pajtim me Kodin për Drejtësi për të Mitur. Programet duhet të hartohen nga ekipi multidisiplinar, ku përpos punëtorit social përgjegjës, kërkohet edhe përfshirja e psikologut, zyrtarit sprovues, edukatorit, të miturit, prindërve apo kujdestarëve dhe institucioneve të tjera relevante;
- ▶ Monitorimi i masave të diversitetit; monitorimi i prokurorive dhe gjykatave përgjatë gjithë procesit, nga fillimi i rastit e deri në ekzekutim;
- ▶ Themelimi i programeve të qëndrueshme për rehabilitimin dhe reintegrimin e të miturve;
- ▶ Ndarja e të miturave nga femrat e rritura të dënuara, për të siguruar ambient të përshtatshëm për rehabilitimin dhe reintegrimin e të miturave me masa dhe atyre të dënuara;
- ▶ Punësimi i stafit profesional si punëtorë social, psikologë, instruktorë profesional, këshillëdhënës, etj. Duhet të ketë burime të mjaftueshme njerëzore për të zbatuar programet individuale, programet rehabilituese dhe reintegruese, si dhe programet edukative.

¹⁵³ Të dhënat nga Qendra Edukuese Korrektuese, 2022

ORGANIZATAT ANËTARE TË KOMF

- Aksioni për Nëna dhe Fëmijë
- Asociacioni për Trajnime Sociale, Hulumtime dhe Avokim
- Balkan Sunflowers Kosova
- Childproof/CIPOF
- CONCORDIA Projekte Sociale
- Down Syndrome Kosova
- Education Comes First
- Handikos Ferizaj
- Handikos Gjakovë
- Hareja
- Network of Peace Movement
- Nevo Koncepti
- OPFAKKOS
- Organizata "Autizmi"
- Organizata Akti
- Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror – OFAP
- PL4Y International
- Programi për të Drejtat Civile
- Public Organization for Local Initiatives and Supports – POLIS
- Qendra e Kujdesit Ditor PEMA
- Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – QKRMT
- Qendra Labyrinth
- Qendra për Arsim e Kosovës – KEC
- Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të qenieve njerëzore
- Qendra për Studime të Avancuara – FIT
- Qendra Sociale Edukative SOS Kopshti
- Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë
- Save the Children në Kosovë
- SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë
- Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës – HANDIKOS
- Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë – PRAK Kosova
- Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët Kosovë – SDSF
- Terre des hommes
- The Ideas Partnership
- Voice of Roma, Ashkali and Egyptians – VoRAE

